



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 713 Akti

Nr. 752 Vendimi

Tiranë, më 3.4.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 2.4.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Platin Aliçka**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë).

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesen ndërkombëtare, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Platin Aliçka, me detyrë prokuror në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 2.4.2024 kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Platin Aliçka gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Z. Platin Aliçka u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.12.2020 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, me trup gjykues të përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Etleda Çiftja dhe Brunilda Bekteshi.
3. Në datën 28.12.2020, komisionerja Brunilda Bekteshi paraqiti një kërkesë për dorëheqje, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke parashtruar arsyet e dorëheqjes nga rivlerësimi i subjektit (për shkak se bashkëshortja e subjektit, znj. E.R , është vajza e dajës së saj), duke vlerësuar se ndodhej në kushtet e “konfliktit në dukje të interesit”.
4. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.12.2020, u ngrit trupi gjykues që do të merrte në shqyrtim kërkesën për dorëheqje të komisioneres Brunilda Bekteshi nga procesi për subjektin e rivlerësimit Platin Aliçka.
5. Në vijim, trupi gjykues, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.1.2021, pasi vlerësoi pretendimet dhe argumentimet e paraqitura prej saj, bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, si dhe në rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2017, vendosi se kërkesa e komisioneres Brunilda Bekteshi duhej pranuar.
6. Në vijim, bazuar në praktikën “Për shpërndarjen me short të çështjeve të subjekteve të rivlerësimit sipas nenit 3, pika 6, shkronja “b” e rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, nga ku ka rezultuar se për trupin gjykues nr. 1 ishte shortuar si anëtar trupi zëvendësues komisioneri Roland Ilia.
7. Gjatë hetimit administrativ është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët (përfshirë edhe anëtarin zëvendësues), siç është përmendur më sipër. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike të datës 19.1.2021, ka konfirmuar mospasjen e ndonjë konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues që i ishin bërë me dije.
8. Në vijim, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 1, datë 12.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit

grykues komisioneren Etleda Çiftja. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

9. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
  - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK, në vijim AKSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
10. Me vendimin nr. 2, datë 13.3.2024, Komisioni vendosi të mbyllë hetimet dhe, në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohet në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
11. Në datën 16.3.2024, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t’u njohur me dosjen dhe provat e administruara (nëse e vlerësonte të nevojshme), në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet e kërkuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 25.3.2024. Subjekti paraqiti shpjegimet e veta brenda afatit të caktuar nga Komisioni.
12. Trupi grykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 27.3.2024, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 2.4.2024, duke e njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

13. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 2.4.2024, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.
14. Në vijim, pasi dëgjoji relacionin, subjekti Platin Aliçka parashtrroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 2.4.2024 u mbyll, për të rifilluar më 3.4.2024 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

15. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

#### **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës së dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancë dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

##### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

###### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

17. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
  - *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
  - *ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;*
  - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
  - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
18. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
19. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

###### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

###### **1. Apartament në Elbasan në bashkëpronësi, në vlerën 2,246,307 lekë**

20. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës si OPGJ, në vitin 2004, subjekti ka deklaruar pasurinë nr. \*\*\* të llojit apartament 2+1, nr. \*\*\*, me sipërfaqe 65.33 m<sup>2</sup>, shkalla \*\*\*, kati \*\*\*, në Elbasan, në bashkëpronësi në masën ¼ e pasurisë, në vlerën 3,000,000 lekë.

21. Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës si prokuror në vitin 2008<sup>1</sup>, subjekti ka deklaruar apartamentin në fjalë në vlerën 4,000,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar pasurinë në fjalë të rivlerësuar në vlerën 2,246,307 lekë.
22. Lidhur me deklarimin e apartamentit në vlera të ndryshme ndër vite, subjekti ka parashtruar në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni se deklarimi është bërë referuar vlerave të tregut në ato vite dhe jo si shkak i investimeve në këtë pasuri. Madje, edhe mobilimi është kryer nga prindërit e tij vite më parë. Po ashtu, ai ka shpjeguar se kjo pasuri është përfituar nga prindërit në cilësinë e ish të përndjekurve politikë, fillimisht me autorizimin e datës 19.7.1999, e në vijim me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 23.5.2000, për blerjen e apartamentit në vlerën 145,917 lekë, të nënshkruar mes shtetases M.A dhe EKB-së.
23. Në vijim, me anë të vendimit nr. \*\*\*, datë 16.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë<sup>2</sup>, apartamenti në fjalë është regjistruar në emër të subjektit, nënës, vëllait dhe motrës së tij, sipas vërtetimit hipotekor nr. regj. \*\*\*, datë 12.6.2000, si dhe të truallit me sipërfaqe 20.97 m<sup>2</sup>. Në vijim, me anë të kontratës së dhurimit nr. \*\*\*, datë 14.11.2017, subjekti, nëna dhe motra ia kanë dhuruar pjesën e tyre z. Y.A (vëllait të subjektit).
24. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se trualli me sipërfaqe 20.97 m<sup>2</sup> ndodhet në pallatin ku ndodhet edhe apartamenti në analizë dhe u përket të gjithë pronarëve që zotërojnë apartamente në atë pallat.
25. ASHK-ja<sup>3</sup> ka bërë me dije se z. Y.A me anë të kërkesës nr. \*\*\*, viti 2005 – 2006, ka aplikuar për legalizim, aplikim i cili është miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2021. Po ashtu, ky institucion ka përcjellë dokumentacionin që i përket pasurisë në analizë, ku ndër të tjera ka rezultuar një vërtetim pronësie i datës 2.3.2021, sipas të cilit pasuria në fjalë rezultoi e regjistruar në emër të z. Y.A.
26. Nisur nga sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar nga ASHK-ja, si dhe në shpjegimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, ka rezultuar se procedura e legalizimit është kryer me qëllim legalizimin e sheshit të ndërtimit të pallatit, i cili është në bashkëpronësi të të gjithë banorëve që disponojnë apartamente në të. Komisioni, referuar vërtetimeve e certifikatës së pronësisë së kësaj pasurie, duke filluar nga viti 1999 deri në vitin 2021, ka konstatuar se sipërfaqja e saj ka qenë 65.3 m<sup>2</sup> dhe ka qëndruar e njëjtë ndër vite, duke mos rezultuar kryerja e ndonjë ndërtimi shtesë pas blerjes. Po ashtu, ASHK-ja nuk ka konfirmuar ekzistencën e ndonjë certifikate apo vërtetimi pronësie për sipërfaqen prej 15 m<sup>2</sup> (apo 20 m<sup>2</sup>) në emër të subjektit apo personave të lidhur, pasi ajo është truall dhe jo sipërfaqe ndërtimi.
27. Subjekti ka deklaruar se në pasurinë në analizë ka banuar deri në korrik të vitit 2008. Librezat e pagesave të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm të apartamentit në fjalë kanë rezultuar në emër të babait të subjektit dhe tarifimet për furnizimin me ujë dhe energji elektrike janë pasqyruar edhe përgjatë vitit 2023.

---

<sup>1</sup> Në këtë vit, subjekti është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

<sup>2</sup> Ky vendim është vënë në dispozicion të Komisionit nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, si dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2023, të ASHK-së Elbasan.

28. Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2023, nga ASIG-u<sup>4</sup>, në të cilën paraqiten koordinatat e vendndodhjes së apartamentit, ortofoto të realizuara nga fotografimi ajror për vitet 2015 – 2017, si dhe foto të brendshme dhe të jashtme të apartamentit. Nga shqyrtimi i ortofotove nuk mund të konkludohet lidhur me ndryshimet e pësuar në strukturën ku ndodhet apartamenti në analizë, për shkak se nuk ka historik të ortofotove që të mund të bëhej krahasimi i ndryshimeve të mundshme ndër vite.
29. Nisur nga sa më sipër, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me deklarin apo ligjshmërinë e përfitimit të pasurisë në analizë, për sa kohë ajo është përfituar nga babai i subjektit nëpërmjet procedurës së privatizimit.

## 2. Apartament në vlerën 46,000 euro, në Tiranë

30. Në DIPPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar pasurinë apartament me sipërfaqe 85 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në bashkëpronësi në masën 20%<sup>5</sup>, me adresë: kati 11 i godinës 12-katëshe, në Tiranë. Kjo pasuri është porositur nga subjekti me anë të kontratës së datës 23.10.2009, të lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.
31. Nga shqyrtimi i kontratës së sipërmarrjes<sup>6</sup> ka rezultuar se çmimi i shitjes ka qenë në vlerën 46,000 euro. Pagesa e parë në shumën 37,000 euro është depozituar nga subjekti në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në Raiffeisen Bank, sipas mandatit të datës 16.10.2009. Subjekti ka shpjeguar<sup>7</sup> se vetë ndërtuesi (S.Sh)/administratori i kompanisë i kishte vënë në dispozicion numrin e llogarisë ku ai duhej të depozitonte pagesën.
32. Pjesa e mbetur e pagesës në shumën 9,000 euro, sipas përcaktimit në kontratë, do të paguhej në datën 30.10.2009. Subjekti ka paraqitur disa mandatpagesa që provojnë likuidimin e kësaj shume në arkën e shoqërisë “\*\*\*\* ” sh.p.k. (3x2, 100 euro, 1x1, 500 euro, 1x1, 200 euro).
33. Referuar ekstraktit të QKB-së së dy shoqërive të sipërpërmendura, ka rezultuar se NIPT-i i shoqërisë është i njëjtë dhe ka ndryshuar vetëm emri, nga “\*\*\*\* ” sh.p.k. në “\*\*\*\* ” sh.p.k., pra bëhet fjalë për të njëjtën shoqëri që ka ndryshuar emrin, por ka të njëjtin administrator.
34. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë në analizë, - të përfituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 29.12.2016, me shoqërinë “\*\*\*\* ”<sup>8</sup> sh.p.k., - në proces regjistrimi<sup>9</sup>. Si burim për krijimin e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar huat e marra në muajin tetor të vitit 2009, si dhe të ardhura nga pjesëtarë të familjes<sup>10</sup>.

<sup>4</sup> Komisioni i është drejtuar Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, i cili me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2023, ka bërë me dije se nuk disponon informacionin e kërkuar.

<sup>5</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka saktësuar se deklarimi i pjesës takuese është bërë duke pasur parasysh përbërjen familjare në vitin 2009, si dhe meqë *de facto* pjesë e familjes ka qenë edhe bashkëjetuesja e tij në atë kohë.

<sup>6</sup> Në këtë kontratë citohej gjithashtu se apartamenti do të dorëzohej brenda muajit mars të vitit 2006. Sipërmarrësit kishin marrë lejen e ndërtimit nr. \*\*\*, datë 27.3.2003. Lidhur me këtë fakt, subjekti ka shpjeguar se bëhej fjalë për një format të vjetër të kontratës, të papërditësuar, të përdorur nga shoqëria, dhe që ai nuk i kishte kushtuar vëmendje.

<sup>7</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

<sup>8</sup> Ndryshuar nga “\*\*\*\*” sh.p.k. në datën 20.11.2007, sipas ekstraktit të QKB-së.

<sup>9</sup> Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 25.1.2016, subjekti ka deklaruar se apartamenti është bërë i banueshëm në tetor të vitit 2009, por ai nuk dispononte certifikatë pronësie, pasi pallati ku bënte pjesë apartamenti nuk ishte ende i regjistruar.

<sup>10</sup> Referuar përgjigjes së DPGJC-së, nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2023 dhe certifikatës së përbërjes familjare të subjektit të datës 22.6.2023, ka rezultuar se subjekti ka pasur në përbërjen e tij familjare nënën, vëllain dhe motrën e tij. Në datën 7.7.2010 ka lidhur martesë me bashkëshorten, e cila është bërë pjesë e kësaj përbërjeje familjare.

35. Lidhur me marrëdhënien e subjektit me pronarët/ortakët/aksionerët dhe përfaqësuesit e shoqërive “\*\*\*\* ” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>11</sup>, prokuroritë pranë të cilave ka ushtruar detyrën subjekti kanë bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të hetuara/pushuara apo të mosfilluara prej tij me palë shtetasit në fjalë dhe as nuk ka rezultuar që ai të ketë qenë përfaqësues i organit të prokurorisë në ndonjë çështje me palë këta shtetas.
36. Komisioni ka kryer një analizë krahasimore mes çmimit të shitblerjes së pasurisë në analizë dhe të dhënave të tregut të lirë gjatë periudhës së blerjes së kësaj pasurie. Referuar udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave në tregun e lirë të banësive për vitin 2008”, për sipërfaqen prej 97 m<sup>2</sup> ka rezultuar një çmim mesatar shitjeje rreth 60,108 euro.
37. Lidhur me sa më sipër, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni<sup>12</sup>, subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 4.3.2021 nga shoqëria “\*\*\*\* ” sh.p.k., ku citohej se çmimi i shitjes është përcaktuar duke mbajtur në konsideratë faktin se apartamenti ndodhej në katin e 12-të dhe nuk ishte shumë i kërkuar nga klientët. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës kontratën nr. \*\*\*, datë 10.4.2010, të nënshkruar mes shoqërisë “\*\*\*\* ” sh.p.k. dhe shtetasve të tjerë, sipas së cilës apartamenti me sipërfaqe 103.9 m<sup>2</sup> është shitur në vlerën 40,000 euro. Pra, për një sipërfaqe më të madhe krahasuar me sipërfaqen e apartamentit në pronësi të subjektit është paguar një shumë më e vogël (6,000 euro më pak nga sa e ka përfituar subjekti).
38. Megjithatë, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me përfitimin e banesës kundrejt një çmimi më të ulët nga çmimi i tregut.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

39. Në prapësimet e tij, subjekti u ka qëndruar të njëjtave shpjegime të dhëna prej tij në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni. Subjekti ka depozituar edhe 6 kontrata shitblerjeje të pasurive në të njëjtën godinë ku ndodhet edhe pasuria e tij<sup>13</sup>.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

40. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionin e paraqitur në mbështetje të tyre (kontratat e ngjashme), në analizë të çmimit të përcaktuar në kontratat e shitjes për metër katror dhe sipërfaqe, trupi gjykues konkludon se arrihen të përfitohen të dhëna që provojnë faktin se subjekti nuk ka përfituar ndonjë çmim preferencial nga shoqëria shitëse për shkak të detyrës. Përkundrazi, rezulton se çmimi në kontratën e shitblerjes së pasurisë së subjektit është më i lartë se ato të referuara në kontratat e ngjashme të paraqitura prej tij.

---

<sup>11</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2023, nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2023 të Prokurorisë së Rrethit Tiranë dhe vërtetimi i datës 27.6.2023 i Prokurorisë së Rrethit Elbasan, shkresa nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2024 e Prokurorisë së Rrethit Sarandë – me anë të të cilave është kërkuar informacion për shtetasit D.I.P, E.H.K, E.V.Gj, A.S.A, H.M.D, L.M, A.A i datëlindjes 22.10.1973, E.A, B.D, L.H, B.A i datëlindjes 14.5.1961, E.L i datëlindjes 27.2.1989, K.B i datëlindjes 12.3.1981, si dhe shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “ \*\*\*\*” sh.p.k.

<sup>12</sup> Pyetësorët nr. 2 dhe nr. 4.

<sup>13</sup> Kontrata nr. \*\*\*, datë 10.5.2010; kontrata nr. \*\*\*, datë 13.4.2010; kontrata nr. \*\*\*, datë 14.4.2010; kontrata nr. \*\*\*, datë 17.4.2010; kontrata nr. \*\*\*, datë 17.4.2010; kontrata nr. \*\*\*, datë 17.4.2010.

41. Ky qëndrim i trupit gjykues mbështetet edhe në faktin se nuk ka rezultuar që subjekti të ketë marrë vendim në kushtet e lidhjes së interesit me shitësin e pasurisë në ndonjë cilësi, çka do të shkonte në kundërshtim me nenin 23, pika 1.

42. Për sa më sipër, referuar qëndrimin të mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 42, datë 18.11.2022, trupi gjykues çmon të nënvizojë faktet se:

42.1 Së pari, në blerjen e kësaj pasurie çmimi i përcaktuar sipas vullnetit të lirë të palëve kontraktuale, i pashoqëruar me ndonjë situatë konflikti interesi në raport me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. apo “\*\*\*\*” sh.p.k., nuk mund të jetë *apriori* përcaktues i kushteve të “trajtimit preferencial”, në kuptim të nenit 23, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, i cili parashikon se: *“Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat”*, vetëm për faktin se çmimi i blerjes nga subjekti është më i ulët nga çmimi i referencës sipas EKB-së.

42.2 Së dyti, duke qenë se nga analiza financiare subjekti ka rezultuar me burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurisë, trupi gjykues i ka vlerësuar shteruese dhe bindëse shpjegimet e subjektit. Të dyja këto aspekte, të cilat mund të lidheshin në parim me momentin kohor objekt rivlerësimi kalimtar, kanë rezultuar pa problematika.

### **2.1 Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar dokumentacionin si në vijim:**

43. ASHK-ja<sup>14</sup> ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar pasuri të paluajtshme, të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur, veç atyre të deklaruara nga vetë subjekti.

44. FSHU-ja<sup>15</sup> dhe UKT-ja<sup>16</sup> nuk kanë konfirmuar kontrata në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur librezat e pagesave për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe datojnë nga janari i vitit 2006, ndërsa faturimet që tregojnë pagesa të kryera për konsum datojnë nga muaji tetor i vitit 2009.

45. Ministria e Drejtësisë<sup>17</sup> dhe DPPPP-ja<sup>18</sup> nuk kanë konfirmuar akte noteriale të ndryshme nga ato të deklaruara nga subjekti dhe të rezultuara sipas regjistrit të kontratave, përcjellë nga Ministria e Drejtësisë.

### **2.2 Analiza e burimeve të blerjes së pasurisë**

46. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në shumën 46,000 euro: hua në shumën 30,000 euro, marrë nga vjehri, z. A.R ; (ii) hua nga z. D.P në shumën 1,500,000 lekë; (iii) hua nga z. E.K në shumën 5,000 euro, si dhe të ardhura nga paga e tij dhe bashkëshortes.

47. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, subjekti ka deklaruar se nëna e tij, znj. M. A, i ka dhënë shumën 9,000 euro pa të drejtë kthimi, shumë të cilën e ka përdorur për arredimin e

<sup>14</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.7.2023.

<sup>15</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021.

<sup>16</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2021.

<sup>17</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2021.

<sup>18</sup> Me shkresën e datës 12.5.2021.



apartamentit<sup>19</sup>. Po ashtu, subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer asnjë investim në pasurinë në analizë dhe vlera e deklaruar prej tij në shumën prej 11,398,500 lekësh përfaqëson vlerën e tregut të shitjes së kësaj pasurie sipas raport-vlerësimit të ekspertit të bërë me qëllim rivlerësimin e saj<sup>20</sup>.

48. Në rubrikën e detyrimeve financiare të deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar se huat janë marrë në vitin 2008, ndërsa formalizimi i tyre me deklaratat përkatëse është bërë në vitin 2011, për shkak se atëherë subjekti ka qenë me detyrë pranë Prokurorisë së Rrethit Sarandë, ndërsa huadhënësit banonin në qytete të tjera. Po ashtu, në këtë seksion, subjekti ka deklaruar huan e marrë nga z. P në vlerën 15,000,000 lekë.
49. Lidhur me konstatimet e mësipërme, Komisioni duke konsideruar edhe deklarin e subjektit në DIPP-në e vitit 2009, deklarimet e subjektit kur është thirrur nga ILDKPKI-ja, bazuar në të dhënat e pasqyruara në deklaratat e nënshkruara për huat e marra prej tij, deklarimet e tij në pyetësorët e dërguar nga Komisioni, si dhe në përshkrimin e burimeve të pasurisë në deklaratën *Vetting*, ka rezultuar se bëhet fjalë për një lapsus në këtë rast nga ana e tij, si për sa i takon vitit kur janë marrë huat, po ashtu edhe për shumën e huas ndaj z. P (duke shtuar një zero vetëm në shifrën e paraqitur në rubrikën e detyrimeve financiare).
50. Subjekti ka shpjeguar se në datën 16.10.2009, në Raiffeisen Bank është kryer pagesa e shumës 37,000 euro me përshkrimin “Blerje apartamenti”, ndërsa pjesa tjetër 9,000 euro është paguar sipas mandatpagesave, si vijon:
  - mandatarkëtimi datë 20.10.2009, në shumën 2,100 euro;
  - mandatarkëtimi datë 1.11.2009, në shumën 2,100 euro;
  - mandatarkëtimi datë 14.11.2009 në shumën 2,100 euro;
  - mandatarkëtimi datë 25.11.2009 në shumën 1,200 euro;
  - mandatarkëtimi datë 12.12.2009, në shumën 1,500 euro.
51. Trupi gjykues përgjatë seancës dëgjimore e pyeti subjektin e rivlerësimit (edhe) lidhur me mosdeklarimin prej tij në deklaratën *Vetting* të burimeve financiare të huadhënësve. Subjekti shpjegoi se ky deklarim nuk i ishte mundësuar në atë moment për shkak të rrethanave faktike, pasi nuk e dispononte asokohe dokumentacionin dhe informacionet e detajuara në raport me burimet e të ardhurave të huadhënësve në fjalë.
52. Nisur nga sa më sipër, duke u bazuar në faktet e konstatuara dhe nën dritën e detyrimeve që rrjedhin për institucionet e rivlerësimit për të hetuar e vlerësuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive, sipas pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, dhe në funksion të verifikimit të burimeve financiare të ligjshme, Komisioni ka kryer hetimin mbi burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, duke përllogaritur edhe mundësitë financiare të personave të tjerë të lidhur, siç trajtohet në vijim.

### **2.2.1 Analiza e burimeve të ligjshme të huadhënësit A.R**

53. Në DIPP-në e vitit 2009, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar një hua në vlerën 30,000 euro, marrë nga shtetasi A.R (babai i bashkëshortes), sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, të datës 6.10.2011, ku citohet se shtetasi A.R i ka dhënë hua subjektit në vitin 2009 shumën 30,000 euro, pa afat.

---

<sup>19</sup> Subjekti është shprehur se nuk disponon fatura, pasi blerjet janë bërë në shuma nën 300,000 lekë dhe se ka kaluar një kohë e gjatë.

<sup>20</sup> Subjekti ka paraqitur raportin e vlerësimit, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

54. Referuar deklaramentit të subjektit në procesverbalin e datës 25.1.2016, të mbajtur nga ILDKPKI-ja, si dhe deklarimeve të tij në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 3, të dërguar nga Komisioni, lidhur me burimin e krijimit të shumës 30,000 euro nga vjehtëri i tij, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer:
- a. Të ardhurat nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes;
  - b. Të ardhurat nga paga e vajzës së tyre, përpara njohjes dhe martesës me z. Aliçka, deri në datën 7.7.2010;
  - c. Të ardhura nga emigrimi në Greqi;
  - ç. Të ardhura nga qiraja e apartamentit të tij në Durrës (3-15 ditore), të cilat janë administruar *cash* dhe më pas janë depozituar prej prindërve të bashkëshortes në Raiffeisen Bank, në emër të znj. D.R. Për këto të ardhura subjekti ka deklaruar se vjehtëri nuk kishte dajeni mbi detyrimin për pagesën e tatimit përkatës;
  - d. Të ardhura në shumën 1,800,000 lekë nga firmat piramidale. Tërheqja e kësaj shume në vitin 1997 është konfirmuar nga Ministria e Financave, si dhe nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 4.
55. Komisioni analizoi rrethanat e faktit të rezultuar nga hetimi, së pari në drejtim të të provuarit të ekzistencës së marrëdhënies së huas, e së dyti në funksion të mjaftueshmërisë së të ardhurave të huadhënësit për të justifikuar me burime të ligjshme dhënien e huas në fjalë.
56. Për sa i përket ekzistencës së marrëdhënies së huas, Komisioni në referencë të dispozitave të Kodit Civil, respektivisht nenet 1050-1055, evidenton se nuk parashikohet për efekt të vlefshmërisë së marrëdhënies së huas një formë e caktuar shkresore, duke e përfshirë këtë veprim juridik të kontratave joformale. Megjithatë, nga hetimi rezultoi se, ndonëse subjekti nuk e ka formalizuar në kohë këtë marrëdhënie (marrë në vitin 2009 dhe nënshkruar deklarata në vitin 2011), ai e ka deklaruar huan në fjalë si në deklaratat periodike, po ashtu edhe në deklaratën *Vetting*.
57. Referuar nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjetër të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka barrën të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila i dhurohet ose i jepet hua prej personit tjetër të lidhur, në këtë rast të shumës 30,000 euro. Në kuptim të kësaj dispozite dhe të qëndrimeve tashmë të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se analizimi i rrethanave të faktit në rastin konkret duhet të fokusohet në dy aspekte:
58. Së pari, nëse provohet se personi tjetër i lidhur mundej t'i realizonte këto të ardhura (shuma 30,000 euro) me burime të ligjshme. Për t'i dhënë përgjigje kësaj çështjeje, trupi gjykues merr në konsideratë faktin se përgjatë periudhës 2006 – 2009, e cila u konsiderua si e arsyeshme të merrej parasysh, si për shkak të faktit se për këtë periudhë u paraqit dokumentacion ligjor provues për të ardhurat, por edhe për shkak të një arsytimi logjik se verifikimi i të ardhurave të personit tjetër të lidhur jo detyrimisht duhet të përfshijë të gjithë periudhën e punësimit të tij, por aq sa është e përshtatshme/nevojshme dhe proporcionale në lidhje me shtrirjen në kohë të krijimit të pasurisë, për sa nuk rezultojnë pretendime apo fakte që e lidhin fitimin e saj me një moment të caktuar kohor, me qëllim provimin e ligjshmërisë

së burimit për vlerën që është objekt huaje. Sipas analizës së kryer në këtë këndvështrim, rezultoi se personi tjetër i lidhur kishte realizuar deri në momentin e dhënies së huas të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës, më se të mjaftueshme për t'i dhënë hua subjektit shumë 30,000 euro (sikurse rezulton nga tabela përkatëse).

59. Së dyti, nëse pas një vlerësimi logjik dhe të përgjithshëm të çdo rasti personi tjetër i lidhur kishte mundësi t'ia jepte hua këtë shumë subjektit të rivlerësimit. Për t'i dhënë përgjigje kësaj çështjeje, trupi gjykues vlerësoi të analizojë faktin nëse me të ardhurat e disponuara prej personit tjetër të lidhur mundet ai sipas një vlerësimi të arsyeshëm të të gjitha rrethanave të jepte hua shumë e pretenduar. Pjesë e këtij vlerësimi është raporti mes të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve për jetesë të personit tjetër të lidhur për periudhën që analizohet. Në këtë kuptim, Komisioni çmon se për të konkluduar nëse shumë e dhënë hua personi tjetër i lidhur, z. R, kishte mundësinë ta ruante, duhet kryer analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve deri në datën e dhënies së huas.
60. Referuar deklarimeve të subjektit mbi burimin e krijimit të shumë 30,000 euro nga vjehri i tij, Komisioni ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e familjes së z. A.R sipas pretendimeve të subjektit, përveç të ardhurave të z. R nga emigrimi në Greqi (për të cilat subjekti nuk ka përcaktuar shumë konkrete dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor që të provonte jetesën e tij si emigrant dhe/apo marrëdhëniet e mundshme të punësimit të tij), si dhe të ardhurave nga qiradhënia (për të cilat subjekti pretendoi se nuk i është kushtuar vëmendje pagesës së detyrimeve tatimore), nuk u provuan me dokumentacion ligjor nga subjekti i rivlerësimit ligjorisht, edhe pse iu dha mundësia për t'i paraqitur ato. Megjithatë, trupi gjykues çmon se edhe nëse do të merreshin në konsideratë të ardhurat e pretenduara nga subjekti, gjithsesi ato nuk do të kishin ndonjë efekt përcaktues në vendimmarrjen e Komisionit, duke pasur parasysh rezultatin e analizës financiare.
61. Në lidhje me likuiditetet në llogaritë bankare të familjes R, të cilat janë bërë të disponueshme në momentin e dhënies së huas, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, si dhe atij të administruar nga Komisioni<sup>21</sup>, është konstatuar se znj. D.R ka depozituar në datën 10.11.2006 një shumë prej 40,000 euro në Raiffeisen Bank. Kjo shumë është maturuar ndër vite dhe në datën 12.11.2008 është tërhequr nga znj. D.R, së bashku me interesat në vlerën 602,19 euro dhe, më pas, depozita është mbyllur. Sipas subjektit, prindërit e bashkëshortes e kanë tërhequr këtë shumë për shkak të pasigurisë në sistemin bankar dhe e kanë pasur gjendje në shtëpi<sup>22</sup>.
62. Lidhur me këtë fakt, Komisioni konstaton se referuar kuadrit ligjor në Republikën e Shqipërisë nuk ka pasur kufizim ligjor për mbajtjen e shumëve *cash* jashtë sistemit bankar, kufizim ky i vendosur vetëm për një kategori personash, subjekte deklaruese pranë ILDKPKI-së sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
63. Nga hetimi i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se përgjatë vitit 2008, kur është tërhequr depozita 40,000 euro nga prindërit e bashkëshortes, deri në vitin 2009, kur ata i kanë dhënë

<sup>21</sup> Me shkresën nr. \*\*\*, datë 26.5.2021, të Raiffeisen Bank.

<sup>22</sup> ISSH-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2017, ka përcjellë të dhënat e disponuara për kontributet e derdhura për z. A.R, për periudhën janar 2012 – prill 2017, pranë Autoritetit Portual Durrës dhe Durrës Container Terminal.

hua subjektit shumë 30,000 euro, nuk është kryer ndonjë investim nga ana e tyre në pasuri të luajtshme<sup>23</sup> apo të paluajtshme<sup>24</sup> në harkun kohor në analizë.

64. Pavarësisht konfirmimit nga Raiffeisen Bank se në datën 12.11.2008 znj. R ka tërhequr shumë 40,602.19 euro, si dhe faktit se kjo shumë ka historik të gjendjes duke filluar nga viti 2006<sup>25</sup> deri në datën 12.11.2008, dhe vlera e saj tejkalon vlerën e dhënë hua, Komisioni referuar qëndrimin të mbajtur nga Kolegji, ku ndër të tjera citohet se: *“Vetëm fakti i pasjes së një aktiviteti tregtar dhe gjendjes së likuiditeteve në sistemin bankar, së bashku me një prezumim për ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave, për sa kohë që qarkullohen nga sistemi bankar, nuk mjaftojnë për të konkluduar se edhe shuma e dhënë hua ka doemos një burim të ligjshëm, ndërkohë që nga të dhënat e deklaruara në organet përkatëse nuk evidentohen për huadhënësin rekorde të fitimit drejtpërdrejt të këtyre të ardhurave”*, ka kryer analizën financiare të krijimit të shumës në fjalë, me qëllim verifikimin e mundësisë së kursimit nga ana e prindërve të bashkëshortes së subjektit, për t’i dhënë hua subjektit shumë 30,000 euro (në datën 16.10.2009).
65. Duke qenë se nga hetimi nuk rezultoi që z. R dhe bashkëshortja e tij të kenë bërë ndonjë investim ku mund të ishte përdorur shuma në fjalë, në analizë janë përfshirë të ardhurat e dokumentuara (sipas llogarive bankare dhe vërtetimeve të pagave) të z. R dhe bashkëshortes së tij, si dhe janë përlllogaritur shpenzimet e jetesës së familjes së z. R për 5 persona, sipas përbërjes familjare të tij, për periudhën 2006 – 16.10.2009.
66. Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat e realizuara nga familja e z. A.R <sup>26</sup>, të cilat u provuan me dokumentacion ligjor, nga ku familja ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme në masën 2,279,766 lekë për krijimin e depozitës prej 40,000 euro në datën 10.11.2006. Por ata kanë rezultuar me një balancë pozitive, pra me mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme në masën 1,932,261 lekë për t’i dhënë hua subjektit shumë 30,000 euro.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

67. Pas njoftimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2024, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Shoqëritë Huamarrëse në Administrim) lidhur me të ardhurat nga veprimtaritë e firmave piramidale, sipas së cilës familja R, përveç të ardhurave në shumë 1,800,000 lekë, ka përfituar edhe

<sup>23</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, DPSHTRR-ja ka bërë me dije se nuk ka rezultuar që familja e z. R të ketë blerë ndonjë automjet gjatë periudhës në analizë.

<sup>24</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2023, të ASHK-së<sup>24</sup> nuk janë konfirmuar investime në pasuri të paluajtshme në harkun kohor në analizë. Ky institucion ka përcjellë dokumentacionin që i përket pasurisë nr. \*\*\* , z. k. \*\*\* , datë 18.12.2015, të ndodhur në plazhin e Durrësit, të cilën z. R e dispononte fillimisht sipas kontratës së qirasë nr. \*\*\* , datë 29.5.1997, të lidhur me Ndërmarrjen Komunale Plazh, e në vijim, pasi ka kryer procedurat e legalizimit, z. R është bërë pronar i kësaj pasurie sipas certifikatës së pronësisë nr. \*\*\* . Gjithashtu, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara<sup>24</sup> ka bërë me dije se z. A.R ka rezultuar vetëdeklarues sipas formularit nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2015, për apartamentin me sip. 58.72 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Kavajë, përfituar sipas kontratës nr. \*\*\* , datë 26.12.2013, por nuk ka rezultuar certifikatë pronësie në emër të tij. ASHK-ja Kavajë<sup>24</sup> ka përcjellë dokumentacionin që i përket godinës 4-katëshe me vendndodhje në Kavajë (në të cilën ndodhet edhe apartamenti i mësipërm), me investitor z. Sh.A, regjistruar në emër të tij në datën 22.2.2008. Po ashtu, dosja në fjalë përmban gjithë dokumentacionin teknik të ndërtimit të kryer nga z. A.

<sup>25</sup> Në këtë periudhë, subjekti nuk ka qenë në detyrë, si dhe nuk kishte nisur bashkëjetesën me bashkëshorten aktuale.

<sup>26</sup> Përfshirë edhe të ardhurat e nënës së z. R, e cila ka qenë anëtare e familjes për periudhën në analizë. Të ardhurat e saj janë përlllogaritur referuar vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021, të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 4, si dhe shkresës nr. \*\*\* , datë 6.2.2024, të ISSH-së.

interesa në masën 8% në muaj për periudhën e vitit 1996 – 1997. Bashkëlidhur kësaj shkrese, në mungesë të kontratës përkatëse të nënshkruar mes z. R dhe “\*\*\*”, ky institucion ka vënë në dispozicion kopje të kontratave tip që përdorte shoqëria “\*\*\*” për periudhën në fjalë, si dhe disa mandatarkëtime, si vijon:

- mandatarkëtimi \*\*\*, datë 22.4.1996, 700,000 lekë;
- mandatarkëtimi \*\*\*, datë 19.6.1996, 400,000 lekë;
- mandatarkëtimi \*\*\*, datë 26.6.1996, 300,000 lekë;
- mandatarkëtimi \*\*\*, datë 1.8.1996, 250,000 lekë;
- mandatarkëtimi \*\*\*, datë 19.10.1996, 150,000 lekë.

68. Subjekti ka parashtruar se nëna e z. A.R (znj. S.R) ka disponuar të ardhura të kursyera nga pensioni në shumën 184,470 lekë, e cila është ekuivalente e vlerës 1,500 euro, sipas librezës së kursimeve pranë Alpha Bank të paraqitur prej tij në cilësinë e provës<sup>27</sup>.
69. Subjekti ka pretenduar edhe një tjetër burim të ardhurash për familjen R, në masën 67,000 lekë. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur një dokument për tërheqjen e çekut të lëshuar nga shoqëria “\*\*\*” për pagesë kundrejt shtetasit A.R me datë 16.4.2008, në vlerën 67,000 lekë.
70. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar edhe të ardhurat në masën 54,000 lekë, për dokumentimin e të cilave ka paraqitur dokumentin e tërheqjes së shumës në fjalë nga z. A.R , nga Banka e Kursimeve, në datën 9.6.1997.
71. Subjekti ka rikërkuar të merren në konsideratë edhe të ardhurat nga qiraja të z. R, të cilat sipas tij janë përdorur për nevojat e tyre jetike<sup>28</sup>.
72. Subjekti ka shpjeguar se duke qenë se z. R nuk ka qenë subjekt deklarues, provat e paraqitura, ndonëse nuk plotësojnë standardet e kërkuara nga ligji nr. 84/2016, mund të ndikojnë në drejtim të krijimit të bindjes së brendshme të trupit gjykues.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

73. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur prej tij, trupi gjykues ka konstatuar se referuar kontratës tip që daton në vitin 1996, në pikën i të saj përcaktohet shprehimisht përqindja e interesit mujor, që huadhënësit përfitonin nëpërmjet nënshkrimit të këtyre kontratave. Në analizë të këtyre të dhënave në raport me shumën prej 1,800,000 lekësh të të ardhurave që z. R ka tërhequr në vitin 1997, fitimi në bazë të interesit prej 8 % në muaj, duke përllogaritur vetëm 3 nga mandatet, ka qenë shumën prej 672,000 lekësh.
74. Në analizë të legjitimitimit të këtyre të ardhurave, trupi gjykues çmon t’i referohet qëndrimit të mbajtur nga Kolegji<sup>29</sup>, në të cilin ndër të tjera citohet se: “... subjekti i rivlerësimit ka mundur të paraqesë dokumente të lëshuara nga institucione shtetërore (Ministria e Financave), që provojnë përfitimet periodike të marra nga familja K. nga huamarrja në firmat piramidale, Kolegji vlerëson se të ardhurat e krijuara nga familja K. prej këtij

<sup>27</sup> Komisioni i kishte përfshirë më herët të ardhurat nga pensioni i znj. R në analizën financiare.

<sup>28</sup> Përveç sa ka paraqitur gjatë hetimit administrativ, së bashku me prapësimet e tij subjekti ka paraqitur edhe deklaratën nr. \*\*\*, datë 24.1.2024, nga z. R, i cili ka deklaruar se ka realizuar të ardhura nga qiraja nga individë të ndryshëm, duke cituar emrat dhe kontakte telefonike të tyre. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë nr. \*\*\*, datë 24.1.2024, nga shtetasi B.T, i cili ka deklaruar se miku i tij A.R disponon 2 pasuri, të cilat gjatë sezonit veror i jep me qira.

<sup>29</sup> Vendimi nr. 15, datë 18.6.2021.

aktiviteti, e të përfituara para miratimit të ligjit nr. 8188, datë 23.1.1997, që ndaloi ushtrimin e kësaj veprimtarie, duhet konsideruar se plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme dhe, për pasojë, janë konsideruar si të tilla në analizën financiare të kryer për kontrollin e burimeve të ligjshme të familjes ...”.

75. Po ashtu, lidhur me të ardhurat e tërhequra prej tij nga BKT-ja, si dhe të ardhurat e përfituara nga shoqëria “\*\*\*”, për të cilat subjekti pretendoi që të përfshihen në analizën financiare, trupi gjykues i konsideroi këto të ardhura si të ligjshme, në kuptim të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pamjaftueshmëria e burimeve financiare për krijimin e depozitës në vlerën 40,000 euro (e cila ishte në vlerën -2,279,766 lekë) është reduktuar, duke rezultuar në shumën -1,486,766 lekë, siç paraqitet në tabelën në vijim:

**Tabela nr. 1** – Analiza financiare e huadhënësit A. R për krijimin e depozitës 40,000 euro deri në datën 10.11.2006

Tab. 1 - analiza e huadhenesit A.R në dt 10.11.2006	Në rezultate	Pas prapësimeve
Të ardhura nga paga A.R 1999- 10.11.2006	2,947,368	2,947,368
Të ardhura nga paga D.R 1996- 10.11.2006	1,538,480	1,538,480
Të ardhura nga paga e b/sh të subjektit 2005- 10.11.2006	673,989	673,989
Të ardhura nga pensioni S.R	248,536	248,536
Të ardhura nga MF	1,800,000	1,800,000
Të ardhurat nga interesat V.H.G		672,000
Të ardhura nga SIGAL		67,000
Të ardhurat nga interesat në BKT		54,000
<b>Total të ardhura deri në dt. 10.11.2006</b>	<b>7,208,373</b>	<b>8,001,373</b>
Shpenzime jetese 2000-10.11.2006	4,169,281	4,169,281
Shpenzime jetese 1996-1999	370,737	370,737
<b>Total shpenzime</b>	<b>4,540,018</b>	<b>4,540,018</b>
<b>Rezultati</b>	<b>2,668,354</b>	<b>3,461,354</b>
Likuiditete	4,948,120	4,948,120
<b>Rezultati në datë 10.11.2006</b>	<b>- 2,279,766</b>	<b>1,486,766</b>

76. Nga sa më sipër, është arritur në konkluzionin se deri në datën 10.11.2006, ndonëse familja R ka rezultuar me pamjaftueshmëri në masën 1,486,766 lekë për krijimin e depozitës në vlerën 40,000 euro, ka pasur një disponibilitet financiar në shumën 3,461,354<sup>30</sup> lekë (deri në datën e dhënies së huas 16.10.2009), pra me mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për t'i dhënë hua subjektit shumën 30,000 euro – sikurse pasqyrohet edhe në tabelën vijuese (nr. 2).

**Tabela nr. 2** – Analiza financiare e huadhënësit A. R për periudhën 10.11.2006 –16.10.2009

Të ardhura nga paga A.R	2,625,524
Të ardhura nga paga D.R	550,403
Të ardhura nga paga e b/sh të subjektit	1,642,383
Të ardhura nga pensioni S.R	173,074
Të ardhura te ligjshme per krijimin e depozites	3,461,354
<b>Total të ardhura deri në dt. 16.10.2009</b>	<b>8,452,738</b>
Shpenzime jetese	1,612,377
<b>Total shpenzime</b>	<b>1,612,377</b>
<b>Rezultati në datë 16.10.2009</b>	<b>6,840,361</b>
Hua dhene subjektit	4,115,100
<b>Diferenca</b>	<b>2,725,261</b>

<sup>30</sup> Kjo vlerë është si rezultat i të ardhurave të ligjshme për krijimin e depozitës 40,000 euro.

77. Kësisoj, bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues arrin në konkluzionin se personi tjetër i lidhur, z. A.R , ka disponuar burime financiare të ligjshme për krijimin e shumës 30,000 euro, të dhënë hua subjektit të rivlerësimit, çka kënaq kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

### 2.3 Lidhur me burimet e subjektit për kthimin pas të huas tek z. R

78. Në procesverbalin e datës 25.1.2016 të mbajtur nga ILDKPKI-ja, subjekti ka deklaruar se për huan e marrë nga vjehri i tij ka likuiduar *cash* 7,000 euro dhe se detyrimi i mbetur në datën 31.12.2014 ka qenë 23,000 euro<sup>31</sup>.

79. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 1, 2 dhe 4, subjekti ka deklaruar se si burim për likuidimin e huas ndaj z. R kanë shërbyer të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes. Kthimi i huas është bërë në disa këste, konkretisht: shuma 3,000 euro është likuiduar në muajin dhjetor të vitit 2012; shuma 4,000 euro në muajin dhjetor të vitit 2013 (pasqyruar në deklaratën periodike vjetore 2013); shuma 3,000 euro është likuiduar *cash*<sup>32</sup> në vitin 2018; dhe, në datën 20.8.2019, nëpërmjet Raiffeisen Bank ka likuiduar shumën 5,000 euro me përshkrimin “Kthim detyrimi”<sup>33</sup>. Subjekti ka deklaruar se kjo hua ka mbetur e pashlyer në shumën 15,000 euro.

80. Për sa më sipër, Komisioni ka analizuar mundësinë e kursimit nga subjekti për likuidimin e shumës 3,000 euro, duke nisur nga data 16.10.2009 kur është marrë huaja nga z. A. R, deri në datën 31.12.2012. Nga analiza e kryer, subjekti ka rezultuar me burime të ligjshme të mjaftueshme për likuidimin e kështit në fjalë, siç paraqitet në tabelën në vijim:

**Tabela nr. 3** – Analiza financiare për likuidimin e huas ndaj z. A.R për pagesën e kështit të parë 3,000 euro në periudhën 17.10.2009 – 31.12.2012

Të ardhura nga paga subjekti	2,973,342
Të ardhura nga pagat bashkëshortes	1,741,759
<b>Total të ardhura</b>	<b>4,715,101</b>
Shpenzime jetese për 3 persona	1,226,199
Shpenzime udhëtimi	167,664
Pagesë principlali i kredise	227,329
Pagese interesi i kredise	378,133
Pagesa e kështit 3000 euro	419,160
Shpenzime qeraje	255,000
Pagesa e huase ndaj E.K	700,000
Likuiditete	169,045
<b>Total pasuri dhe shpenzime</b>	<b>3,542,531</b>
<b>Rezultati në datë 31.12.2012</b>	<b>1,172,570</b>

81. Gjithashtu, Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit për likuidimin e shumës 4,000 euro në vitin 2013 sipas deklaramit të tij, nga ku subjekti ka rezultuar me burime të ligjshme për likuidimin e kësaj shume, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

<sup>31</sup> Në këtë procesverbal, subjekti ka deklaruar se në datën 20.8.2019 ka shlyer me transfertë bankare shumën 5,000 euro, ekuivalente në 605,950 lekë. Në vitin 2021 ka shlyer shumën 5,000 euro, ekuivalente në 60,200 lekë me transfertë bankare dhe në vitin 2022 ka shlyer shumën 5,000 euro, ekuivalente në 579,958.64 lekë me transfertë bankare. Nga huaja e marrë në vlerën 30,000 euro ka ende pa likuiduar 5,000 euro.

<sup>32</sup> Referuar deklaramit të subjektit në procesverbalin e datës 22.6.2011, të mbajtur nga ILDKPKI-ja.

<sup>33</sup> Po aty, subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga pagat.

**Tabela nr. 4** – Analiza financiare për likuidimin e huas 4,000 euro nga subjekti ndaj z. A.R (për pagesën e këstit të dytë) në dhjetor të vitit 2013

Të ardhura nga paga subjekti	968,711
Të ardhura nga pagat bashkëshortes	734,961
Të ardhura të mbartura nga viti i mëparshëm	1,172,570
<b>Total të ardhura</b>	<b>2,876,242</b>
Shpenzime jetese për 3 persona 2013	423,072
Pagesë principali i kredise	119,510
Pagese interesi i kredise	118,322
Pagesa e këstit 4000 euro	560,840
Likuiditete në bankë	223,765
Shpenzime qeraje	90,000
<b>Total pasuri dhe shpenzime</b>	<b>1,535,509</b>
<b>Rezultati në datë 31.12.2013</b>	<b>1,340,733</b>

82. Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare, të mjaftueshme për pagesën e kësteve të kthimit të huas ndaj z. R, konkretisht 3,000 euro në vitin 2012 dhe 4,000 euro në vitin 2013.

#### 2.4 Analiza e burimeve të ligjshme të huadhënësit D.P

83. Në DIPP-në e vitit 2009, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar huan në vlerën 1,500,000 lekë, të marrë nga shtetasi D.P (i afërm i babait të subjektit), sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 25.9.2011, në të cilën z. P ka deklaruar se në vitin 2009 i ka dhënë hua z. Platin Aliçka shumën 1,500,000 lekë.

84. Si burim për këtë hua, në përgjigje të pyetësorët nr. 1 dhe 2, subjekti ka deklaruar kursimet e tij dhe familjes nga punësimi, aktivitetet tregtare të ushtruara prej tij në qytetin e Elbasanit, si dhe një depozitë bankare që dispononte bashkëshortja e z. P. Sipas subjektit, znj. P ka marrë një *overdraft*, të cilin e ka likuiduar me likuiditetet e ndodhura në depozitën në fjalë, pasi kjo është maturuar.

85. Referuar deklaratimit të subjektit në DIPP-në e vitit 2009, huaja në analizë është marrë në datën 17.10.2009, ndërkohë që depozita në emër të znj. P, e cila sipas tij ka shërbyer si burim për këtë hua, ka qenë e mbyllur me afat maturimi në datën 22.10.2009. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogarinë bankare të sipërcituar, ka rezultuar se znj. U.P<sup>34</sup> në datën 8.10.2009 ka marrë një *overdraft* në shumën 1,850,000 lekë, të cilin e ka shlyer me likuiditetet e ndodhura në depozitën e sipërcituar, në datën 22.11.2009 (pra, pasi kjo depozitë është maturuar).

86. Gjatë hetimit, Komisioni ka kërkuar informacion lidhur me fitimin e realizuar nga aktivitetet tregtare të ushtruara nga z. P. DRT-ja Elbasan<sup>35</sup> ka bërë me dije se shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk ka rezultuar të kenë kryer pagesë për tatimin mbi dividendin pranë kësaj drejtorie, për rrjedhojë nuk u provua me dokumentacion ligjor burimi i të ardhurave të ligjshme nga aktiviteti tregtar i ushtruar nga z. P. Në këto kushte, Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të z. P dhe bashkëshortes së tij për t’i dhënë hua subjektit shumën 1,500,000 lekë në vitin 2009. Në analizë janë përfshirë të ardhurat e tyre nga punësimi, të dokumentuara me anë të vërtetimeve përkatëse duke filluar nga viti 2004, shpenzimet e tyre (për të njëjtën periudhë) deri në datën 17.10.2009, kur është dhënë huaja në fjalë, si dhe

<sup>34</sup> Nga Prokuroria e Rrethit Sarandë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2024 dhe ajo Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2024, është konfirmuar se nuk kanë rezultuar çështje të shqyrtuara nga subjekti ku kjo shtetase të ketë qenë palë.

<sup>35</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2023, të paraqitura nga subjekti.



likuiditetet e disponuara nga znj. P në llogarinë e saj, në Intesa Sanpaolo Bank, të cilat janë bërë të disponueshme në datën 8.10.2009 (përpara se të jepej huaja). Nga analiza e kryer ka rezultuar një balancë pozitive në masën 2,698,125 lekë, siç paraqitet në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 5** – Analiza e burimeve të ligjshme të huadhënësit D. P për periudhën 2004 – 17.10.2009

Të ardhura nga paga D.P	2,142,274
Të ardhura nga paga U.P	1,589,257
Likuiditete në bankë	1,856,887
<b>Total të ardhura</b>	<b>5,588,418</b>
Shpenzime jetese	1,390,292
Hudhënie P.A	1,500,000
Total pasuri dhe shpenzime	2,890,292
<b>Rezultati në datë 17.10.2009</b>	<b>2,698,125</b>

87. Për sa më sipër, z. P ka rezultuar me burime të ligjshme, të mjaftueshme për t'i dhënë subjektit huan në shumën 1,500,000 lekë.
88. Lidhur me marrëdhënien me z. P, subjekti ka deklaruar se z. P është i afërmi i babait të tij. Ai ka paraqitur vërtetime nga prokuroritë ku ka ushtruar detyrën, në të cilat bëhet me dije se subjekti nuk ka hetuar çështje ku të kenë qenë të përfshirë z. D.P dhe/apo bashkëshortja e tij. Ky fakt është konfirmuar edhe nga informacioni i përcjellë nga prokuroritë e rretheve gjyqësore Sarandë<sup>36</sup> dhe Elbasan<sup>37</sup>, pranë të cilave ka ushtruar detyrën subjekti i rivlerësimit.
89. Gjithashtu, SPAK-u<sup>38</sup> ka bërë me dije se shtetasi D. P nuk rezultonte me rekorde kriminale të mundshme apo i përfshirë në krimin e organizuar.

## 2.5 Lidhur me burimet financiare të subjektit për kthimin pas të huas së marrë tek z. P

90. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar se ka likuiduar shumën 1,000,000 lekë, si burim i së cilës ka shërbyer gjendja *cash* dhe të ardhurat e vitit 2011. Në pyetësin nr. 1, subjekti ka saktësuar se ky është një lapsus, pasi bëhet fjalë për të ardhurat e vitit 2010. Po në këtë pyetësor, veç sa më sipër, subjekti ka deklaruar si burim edhe një kredi të marrë prej tij në muajin janar të vitit 2011, në Raiffeisen Bank, në datën 18.6.2010, në shumën 960,000<sup>39</sup> lekë.
91. Në procesverbalin e datës 25.1.2016 të mbajtur nga ILDKPKI-ja, subjekti ka deklaruar se huaja është marrë *cash* nga subjekti dhe kthimi është bërë gjithashtu *cash*, dhe se detyrimi i mbetur i palikuiduar deri në datën 31.12.2014 ka qenë në shumën 500,000 lekë.
92. Për sa më sipër, Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 200,000 lekë të deklaruar prej tij në DIPP-në e vitit 2008, si dhe në DIPP-në e vitit 2011. Nga analiza e kryer ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim:

**Tabela nr. 6** – Analiza financiare e gjendjes *cash* për periudhën 1.8.2008 – 31.12.2009

<sup>36</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2023.

<sup>37</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2023.

<sup>38</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2023.

<sup>39</sup> Referuar kontratës së kredisë, qëllimi i përcaktuar për marrjen e saj ka qenë për arsye personale.

Të ardhura nga paga subjektit	400,632
<b>Total të ardhura</b>	<b>400,632</b>
Shpenzime jetese	56,925
Shpenzime qeraje	37,500
Gjedje cash	200,000
<b>Total pasuri dhe shpenzime</b>	<b>294,425</b>
<b>Rezultati në datë 31.12.2008</b>	<b>106,207</b>

93. Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të subjektit për likuidimin e kësaj shume, duke filluar nga data 1.1.2011 (momenti i likuidimit të kështit të parë) deri në datën 31.12.2015, kur është pretenduar likuidimi i plotë i shumës në fjalë, sipas deklaramit të subjektit në DIPP-në e vitit 2015, siç paraqitet e detajuar në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 7** – Analiza financiare për likuidimin e shumës 500,000 lekë ndaj z. D.P për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2015

Të ardhura nga paga subjekti	5,018,061
Të ardhura nga pagae bashkëshortes	3,795,270
<b>Total të ardhura</b>	<b>8,813,331</b>
Shpenzime jetese për 3 persona	2,584,398
Shpenzime udhëtimi	305,745
Pagesë principali i kredise	589,789
Pagese interesi i kredise	557,266
Pagesa e kështit 500,000 lekë	500,000
Shpenzime arsimit për djalit	150,000
Shpenzime transporti	50,000
Shpenzime qeraje	375,000
Pagesa e kështeve për huanë nga A.R	980,000
Likuiditete	1,205,738
<b>Total pasuri dhe shpenzime</b>	<b>7,297,936</b>
<b>Rezultati në datë 31.12.2015</b>	<b>1,515,395</b>

94. Nga sa më sipër, subjekti ka rezultuar me burime të ligjshme financiare, të mjaftueshme për likuidimin/kthimin pas të kështit të huas ndaj z. P, në shumën 500,000 lekë në vitin 2015.

## 2.6 Analiza e burimeve të ligjshme të huadhënësit E.K

95. Në DIPP- në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar huan e marrë nga z. K në shumën 5,000 euro, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 6.10.2011, dhe po në këtë deklaratë ka deklaruar se ka likuiduar 100,000 lekë nga kjo hua. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar se ka likuiduar pjesën e mbetur të huas në fjalë. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të likuiduar plotësisht huan në fjalë.
96. Si burimi krijimi të shumës së marrë hua subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e punësimit të djalit të huadhënësit, shtetasit S.K, në shtetin grek, lidhur me të cilat në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka vënë në dispozicion dokumentacionin ku provohet pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara prej djalit të z. K, si dhe në deklaratë të tij për burimin e të ardhurave.
97. Bazuar në të dhënat e disponuara nga Komisioni, është përlllogaritur disponibiliteti financiar për kursimin e shumës 5,000 euro nga z. S.K, shumë të cilën ia ka dhënë babait të tij, si dhe të ardhurat e vetë z. E.K, të dokumentuara deri në datën 26.6.2009. Nga analiza e kryer është konstatuar se z. S.K, së bashku më babain e tij, z. E.K, ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -330,377 lekë për t'i dhënë subjektit shumën 5,000 euro, siç paraqitet më poshtë:

**Tabela nr. 8** – Analiza financiare për shtetasit S.K dhe E.K për periudhën 2000 – 17.10.2009

Të ardhura viti 2000	841,984
Të ardhura viti 2002	785,005
Të ardhura viti 2008	876,074
Të ardhura viti 2009	657,767
Të ardhura nga paga E.K	269,044
<b>Total të ardhura</b>	<b>3,429,875</b>
Shpenzime jetese 2000	581,300
Shpenzime jetese 2002	611,871
Shpenzime jetese 2008	798,223
Shpenzime jetese 2009	946,061
Shpenzime jetese E.K	136,946
<b>Total shpenzime</b>	<b>3,074,401</b>
<b>Rezultati në 26.6.2009</b>	<b>355,473</b>
Hua Subjektit	685,850
<b>Diferenca</b>	<b>- 330,377</b>

98. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni arriti në përfundimin se huaja e dhënë nga z. E. K duhet të merret në konsideratë si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit vetëm në vlerën prej 355,473 lekësh të justifikuar me burime të ligjshme dhe të përfshihet si e tillë në analizën financiare për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve për krijimin e pasurisë objekt kontrolli.
99. Për sa i përket marrëdhënies me z. K, subjekti ka deklaruar se ai është bashkëshorti i hallës së bashkëshortes së tij dhe se nuk ka hetuar ndonjë çështje ku shtetasi në fjalë të ketë qenë i përfshirë. Në mbështetje të deklaramit të tij, ai ka paraqitur vërtetime nga prokuroritë pranë të cilave ka ushtruar detyrën. Sa më sipër është konfirmuar edhe nga prokuroritë e rretheve gjyqësore Sarandë<sup>40</sup> dhe Elbasan<sup>41</sup>, pranë të cilave ka ushtruar detyrën subjekti i rivlerësimit.
100. Gjithashtu, SPAK-u<sup>42</sup> ka bërë me dije se nuk disponohen të dhëna që shtetasi E. K të rezultonte me rekorde kriminale të mundshme apo i përfshirë në krimin e organizuar.
101. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova e shpjegime të tjera bindëse për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

102. Subjekti ka parashtruar se si burim për huan e dhënë nga z. K kishin shërbyer të ardhurat e realizuara nga fëmijët e tij në emigrim. Ai ka ritheksuar se gjatë hetimit të kryer nga Komisioni kishte mundur të siguronte dokumentacionin mbi burimin e të ardhurave vetëm për njërin prej djemve të z. K. Ndërsa për djalin tjetër, ndonëse ka bërë disa përpjekje (ka paraqitur edhe komunikimet me të), nga ana e tij nuk i është vendosur në dispozicion dokumentacioni provues i burimit të ligjshëm të të ardhurave të tij. Duke qenë se ai jeton e punon në Itali, subjekti është shprehur se është në pamundësi objektive për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit lidhur me balancën negative të rezultuar për z. K në shumën - 330,377 lekë.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

<sup>40</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2023.

<sup>41</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2023.

<sup>42</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2023.

103. Në analizë të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se ndonëse nga subjekti i rivlerësimit nuk u provua me dokumentacion disponibiliteti i plotë financiar i z. K, për t'i dhënë hua subjektit shumën 5,000 euro, për shkak të mosdokumentimit të të ardhurave të djalit tjetër të tij, si më sipër përshkruar, edhe nëse do të merreshin në konsideratë të ardhurat e pretenduara nga subjekti, gjithsesi ato nuk do të kishin ndonjë efekt përcaktues në vendimmarrjen e Komisionit, duke pasur parasysh masën e balancës negative, si dhe faktin se balanca negative e rezultuar mbulohet me disponibilitetin e familjes së subjektit, i deklaruar si burim në deklaratën *Vetting*.

## 2.7 Lidhur me burimet e subjektit për kthimin pas të huas, tek z. K

104. Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar se ka likuiduar shumën 100,000 lekë<sup>43</sup> dhe në DIPP-në e vitit 2010 ka deklaruar se ka likuiduar shumën 600,000 lekë ndaj z. K, me burim nga paga e tij dhe e bashkëshortes, dhe kthimi është bërë *cash*.
105. Për sa më sipër, Komisioni ka analizuar mundësinë e kursimit nga subjekti për likuidimin e shumës 100,000 lekë, duke nisur nga data 16.10.2009, kur është marrë huaja nga z. E. K, deri në datën 31.12.2009, siç paraqitet në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 9** – Analiza financiare për likuidimin e shumës 100,000 lekë ndaj z. E. K për periudhën 16.10.2009 – 31.12.2009

Të ardhura nga paga subjekti	186,519
Të ardhura nga pagae bashkëshortes	102,584
<b>Total të ardhura</b>	<b>289,103</b>
Shpenzime jetese për 2 persona	58,391
Pagesa e kështit 100.000 lekë	100,000
Shpenzime qeraje	15,000
<b>Total shpenzime</b>	<b>173,391</b>
<b>Rezultati në datë 31.12.2009</b>	<b>115,712</b>

106. Gjithashtu, Komisioni ka përllogaritur mundësinë financiare të subjektit për të likuiduar shumën 600,000 lekë në dhjetor të vitit 2010 me të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes (sipas deklaratimit të subjektit), siç paraqitet në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 10** – Analiza financiare për likuidimin e shumës 600,000 lekë ndaj z. E. K për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2010

Të ardhura nga paga subjekti	901,492
Të ardhura nga pagae bashkëshortes	261,266
Të ardhura të prapambetura	115,712
<b>Total të ardhura</b>	<b>1,278,470</b>
Shpenzime jetese për 3 persona	341,550
Pagesë principali i kredise	44,294
Pagese interesi i kredise	79,099
Shlyerje detyrimi ngaj huamarrësit E.K	600,000
Shpenzime qeraje	60,000
<b>Total pasuri dhe shpenzime</b>	<b>1,124,943</b>
<b>Rezultati në datë 31.12.2010</b>	<b>153,527</b>

<sup>43</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka deklaruar se shumën prej 100,000 lekësh ndaj z. K e ka likuiduar në muajin dhjetor të vitit 2009 dhe shumën 600,000 lekë në dhjetor të vitit 2010.

107. Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kthimin pas të huas në shumën 600,000 lekë ndaj z. K.

## **2.8 Analiza e burimeve të ligjshme të nënës dhe familjes së subjektit për kursimin e shumës 9,000 euro**

108. Në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni (nr. 1, 2 dhe 3), subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e pasurisë apartament në pronësi të tij edhe shumën 9,000 euro, dhënë nga nëna e tij në vitin 2009, shumë e cila është shpenzuar për arredimin e kësaj pasurie. Ai ka shpjeguar se shumën në fjalë nuk e ka deklaruar në DIPP-në e këtij viti, pasi nuk e ka konsideruar hua dhe se kjo shumë është marrë dhe shpenzuar brenda vitit 2009. Subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të nënës së tij, nr. \*\*\*, datë 27.6.2023, në të cilën znj. M.A ka deklaruar se i ka dhënë subjektit në vitin 2009 shumën 9,000 euro pa të drejtë kthimi.

109. Si burim krijimi të shumës në fjalë subjekti ka deklaruar të ardhurat nga testamenti i lënë i të ndjerit gjysh të tij (H.B në SHBA), së bashku me interesat bankarë nga investimi në depozita 3 dhe 6-mujore në BKT, në shumën totale rreth 41,000 USD<sup>44</sup> (38,000 USD nga trashëgimia dhe 3,000 USD interesa të përfituar nga qëndrimi në depozitë). Ai ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021, nga BKT-ja, ku citohet se pas vitit 2000 nuk rezultonte llogari bankare në emër të shtetasve M dhe B.A. Subjekti ka paraqitur një ekstrakt të llogarisë së të ndjerës gjyshes së tij, R.A, të datës 1.1.1988, lidhur me të ardhurat nga trashëgimia e bashkëshortit të saj, sipas së cilës ka rezultuar se nëpërmjet avokatit të saj znj. R i ka transferuar shumën 32,250 USD<sup>45</sup>.

110. Subjekti ka shpjeguar se shumat e përfituara nga testamenti, si dhe nga interesat bankarë, janë marrë përkatësisht sipas mandateve për dhënie valute të BKT-së, që datojnë në datat 2.12.1993, 7.9.1994 dhe 12.1.1995, janë administruar nga nëna e tij dhe kanë qenë në dispozicion të familjes për çdo nevojë, pasi nëna ka jetuar gjatë gjithë kohës me ta<sup>46</sup>. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që prindërit e subjektit të kenë kryer ndonjë investim në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, ku mund të ishin përdorur të ardhurat në fjalë.

111. Në analizë të sa më sipër, duke u bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, konkretisht: (i) testamenti i vitit 1987 i lënë nga i ndjeri H. B në SHBA, sipas të cilit vërtetohet se z. B.A është trashëgimtar në masën  $\frac{1}{4}$  e pasurisë së tij, pjesë e cila është trashëguar më pas nga znj. M. A; (ii) testamenti nr. \*\*\*, datë 24.7.1990, me anë të të cilit e ndjera R.B pjesën e saj, në masën  $\frac{1}{2}$  e pasurisë së trashëguar nga bashkëshorti, i ndjeri H.B, ua ka lënë me testament fëmijëve (Platin, Y dhe E) të djalit të saj, të ndjerit B.A ; (iii) mandatet bankare të babait dhe nënës së subjektit për depozitimin e shumës 500,000 lekë në depozitë 6-mujore, me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, në vitin 1996, shumën 1,000,000 lekë në depozitë kursimi me afat, me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, në vitin 1996, si dhe shumën 500,000 lekë, në depozitë me afat 6-mujor, me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, në vitin 1996; (iv) bazuar në shpjegimet e subjektit se të ardhurat e trashëguara janë administruar nga nëna dhe janë përdorur nga familja për çdo nevojë, në kushtet kur: (v) gjatë hetimit të kryer nga Komisioni

<sup>44</sup> 18,000 USD me kurs 94,5 = 1,701,000 lekë, datë 2.12.1993; 3,000 USD me kurs 84,8 = 254,400 lekë, datë 7.9.1994; 20,000 USD me kurs 94.3 = 1,886,000 lekë, datë 12.1.1995. Shuma 38,000 USD është përfituar nga babai i subjektit si trashëgimtar ligjor i babait të tij. Pas vdekjes së babait të subjektit, shuma në fjalë është administruar nga nëna e tij.

<sup>45</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

<sup>46</sup> Përcjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

nuk rezultoi që nëna, vëllai dhe motra e subjektit të kenë kryer ndonjë investim në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme; (vi) po ashtu, duke mbajtur në konsideratë marrëdhënien e posaçme prind-fëmijë të subjektit me znj. M.A , si dhe faktin se ajo ka bashkëjetuar dhe ka qenë në certifikatën e familjes së subjektit, të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e nënës duhet të përlogariten në analizën financiare gjithëpërfshirëse të familjes së subjektit (e, për pasojë, nuk mund të përjashtohet mundësia e përdorimit të shumave të kursyera e disponuara nga nëna e subjektit për arredimin e apartamentit – sikurse ka shpjeguar subjekti).

112. Kësisoj, nisur nga pretendimi i subjektit, Komisioni fillimisht ka analizuar të ardhurat dhe shpenzimet e nënës së subjektit (e cila ka qenë në një certifikatë familjare dhe bashkëjetuese me subjektin në periudhën e shpenzimeve/burimeve objekt analize), sikurse edhe të anëtarëve të tjerë të familjes së subjektit, me qëllim verifikimin e disponibilitetit financiar të shumës 9,000 euro (me burim nga kursimet e nënës dhe trashëgimia).
113. Nga analiza e kryer, duke nisur nga data 1.8.2008 (momenti kur subjekti ka filluar detyrën) deri në datën 16.10.2009, kur ka filluar përdorimi i apartamentit në fjalë (referuar pretendimit të subjektit se kjo shumë është përdorur për arredim), subjekti dhe personat e lidhur kanë rezultuar me një balancë pozitive në masën 3,751,830 lekë, siç paraqitet në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 11** – Analiza lidhur me disponibilitetin financiar të shumës 9,000 euro për periudhën 1.8.2008 – 16.10.2009

Të ardhura nga paga e subjektit	1,177,170
Të ardhura nga paga e b/sh së subjektit	608,400
Të ardhura nga pensioni nëna	224,466
Të ardhura nga paga i vëllai	524,682
Të ardhura nga trashëgimia	3,841,400
Të ardhura nga paga e motra	137,716
<b>Totali I të ardhurave</b>	<b>6,513,834</b>
Shpenzime jetese	831,105
Shpenzime qiraje	112,500
Shpenzime udhëtimi	383,869
Shpenzime mobilimi	1,234,530
<b>Total I shpenzime</b>	<b>2,562,004</b>
Gjendje Cash	200,000
<b>Total Pasuri</b>	<b>200,000</b>
<b>Rezultati ne datë 16.10.2009</b>	<b>3,751,830</b>

114. Megjithatë, edhe nëse nuk do të konsiderohej në analizën financiare të subjektit shuma 9,000 euro, sërish situata financiare do të rezultonte me balancë pozitive, për shkak se mbulohet nga disponibiliteti financiar i familjes.
115. Gjithashtu, Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të për krijimin e pasurisë apartament, të blerë në vitin 2009, duke marrë në konsideratë edhe huat e marra për këtë qëllim (të cilat janë konsideruar e përlogaritur vetëm në masën që janë provuar burimet e ligjshme të krijimit me dokumentacion ligjor), dhe në përfundim të së cilës subjekti dhe familja e tij kanë rezultuar me burime të ligjshme për krijimin e pasurisë në fjalë, siç është paraqitur me zërat përkatës dhe në mënyrë të përmbledhur në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 12** – Analiza financiare e familjes së subjektit për periudhën 1.8.2008 – 12.12.2009

Të ardhura nga paga e subjektit	1,363,689
Të ardhura nga paga e b/sh së subjektit	762,712
Të ardhura nga pensioni nëna	255,740
Të ardhura nga paga i vëllai	661,586
Të ardhura nga paga e motra	309,008
Të ardhura nga trashëgimia	3,841,400
Te ardhura nga A.R	4,115,100
Të ardhura nga huaja E.K	355,473
Të ardhura nga huaja D.P	1,500,000
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>13,164,708</b>
Shpenzime jetese	944,955
Shpenzime udhëtimi	397,586
Shpenzime mobilimi	1,234,530
Pagesë huaje E.K	100,000
Blerje apartamenti ne Tiranë	6,309,820
Shpenzime qiraje	127,500
Likuiditete	143,741
Gjendje cash	200,000
<b>Total shpenzime dhe pasuri</b>	<b>9,458,132</b>
<b>Rezultati ne datë 12.12.2009</b>	<b>3,706,577</b>

116. Nisur nga sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime mbi pasaktësitë dhe konfuzionin e krijuar përmes deklarimeve të tij përgjatë hetimit administrativ, lidhur me shumën 9,000 euro, të përfituar nga nëna dhe të padeklaruar në DIPP-në e vitit 2009.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

117. Subjekti ka parashtruar se ka shpenzuar në total shumën 55,000 euro (me burim nga huat dhe 9,000 euro i janë dhuruar nga nëna). Me këtë shumë ai ka blerë dhe ka ardhur apartamentin në pronësi të tij.
118. Lidhur me shumën 9,000 euro, subjekti ka shpjeguar se me to ka blerë pajisje të ndryshme për mobilimin e apartamentit në vlera që nuk i kalonin 300,000 lekë (për pajisje), që të kishte detyrim ligjor për deklarim vjetor. Duke qenë se dhe apartamenti, dhe mobiliet janë likuiduar në të njëjtin vit, kjo ka bërë sipas subjektit që të krijohet paqartësi lidhur me deklaratimet e tij. Po ashtu, gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka deklaruar se nga nëna ka marrë vetëm një herë të ardhura në shumën 9,000 euro, të cilat i ka përdorur për arredimin e banesës. Ndërsa shuma tjetër në këtë vlerë, me burim nga huat, është përdorur për likuidimin e pjesës së mbetur të çmimit të apartamentit (sipas mandateve në vlerën totale 9,000 euro).

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

119. Trupi gjykues çmon se, ndonëse subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 shumën që i është dhënë nga nëna, duke konsideruar marrëdhënien e posaçme, dhe faktin që kjo e fundit ishte anëtare e familjes së subjektit *de facto* dhe *de jure*, nga njëra anë nuk kishte detyrim për ta deklaruar shumën në fjalë, për sa kohë ka qarkulluar brenda së njëjtës ekonomi familjare dhe, nga ana tjetër, edhe nëse kjo do të konsiderohej si pasaktësi, për sa kohë që ka rezultuar e pashoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e shumës në analizë, nuk mund të vlerësohet si një pamjaftueshmëri e deklaratimit të subjektit.

### **3. Automjet tip “\*\*\*”, në vlerën 300,000 lekë**

120. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2004<sup>47</sup> si OPGJ e, në vijim, në deklaratën e interesave privatë “Para fillimit të detyrës si prokuror në vitin 2008”, automjetin tip “\*\*\*\*”, me targë EL \*\*\*, në vlerën 300,000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka saktësuar se ka pasur në pronësi automjetin në fjalë, i cili është blerë në vitin 1997, në shumën 380,000 lekë.
121. DPSHTRR-ja<sup>48</sup> ka konfirmuar se në emër të z. Platin Aliçka dhe bashkëshortes së tij nuk kanë rezultuar automjete në pronësi. Gjithashtu, ky institucion ka konfirmuar daljen nga qarkullimi të automjetit tip “\*\*\*\*” në vitin 2012. Ky fakt ka rezultuar i deklaruar nga subjekti edhe në procesverbalin e datës 25.1.2016 të mbajtur nga ILDKPKI-ja.
122. Nisur nga fakti se automjeti në fjalë nuk ka qenë pasuri e disponuar në momentin e nisjes së procesit të rivlerësimit, si dhe faktit se ai është përfutur nga subjekti rreth 8 vite përpara fillimit të detyrës nga subjekti si prokuror, në referencë edhe të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji<sup>49</sup>, Komisioni ka konkluduar se në mungesë të problematikave nuk gjen shkak për kryerjen e hetimeve mbi burimet e krijimit të kësaj pasurie (të mëhershme).

#### **4. Kredi në shumën 1,000,000 lekë, marrë në Raiffeisen Bank**

123. Në DIPP-në e vitit 2010, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se ka marrë kredi në Raiffeisen Bank në shumën 1,000,000 lekë, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 18.6.2010, me afat shlyerjeje 7 vjet. Detyrimi i mbetur pa likuiduar dhe i deklaruar në deklaratën *Vetting* ka qenë në shumën 90,411 lekë. Në mbështetje të deklarimit të tij, subjekti ka paraqitur një vërtetim nga Raiffeisen Bank të datës 20.1.2017 për shlyerjen e kredisë gjatë viteve 2010 – 2017.
124. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se kjo kredi në shumën prej 969,000 lekësh është disbursuar në datën 18.6.2010 dhe është shlyer deri në datën 18.6.2017. Për sa më sipër, lidhur me deklarimin e kredisë dhe me pagesën e kësteve përkatës nga subjekti, nuk janë konstatuar problematika.

#### **5. Gjendje *cash* në vlerën 1,200,000 lekë**

125. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2008 gjendje *cash* në shumën 200,000 lekë nga kursimet nga paga. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar se e ka përdorur këtë shumë për likuidimin/kthimin e pjesshëm të huas prej 1,500,000 lekësh ndaj z. P.
126. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar kursime nga paga në shumën 470,000 lekë; në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar kursime nga paga në shumën 400,000 lekë; në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar kursime *cash* nga paga e tij dhe e bashkëshortes në shumën 540,000 lekë; në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* të akumuluar ndër vite, në shumën 1,200,000 lekë, si dhe ka bashkëlidhur vërtetimet mbi të ardhurat e tij nga paga ndër vite<sup>50</sup>.

<sup>47</sup> Në deklaratën përpara fillimit të detyrës si OPGJ.

<sup>48</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021.

<sup>49</sup> Vendimi (JR) nr. 7, viti 2020.

<sup>50</sup> Vërtetim nr. \*\*\*, datë 4.10.2016, për të ardhurat në periudhën 1998 – 1999, në shumën 130,665 lekë; vërtetim nr. \*\*\*, datë 18.1.2017, për të ardhurat në periudhën shkurt 1999 – janar 2016, në shumën 3,982,591 lekë; vërtetim nr. \*\*\*, datë 18.10.2016, për të ardhurat në periudhën 2004 – 2008, në shumën 3,181,564 lekë; vërtetim nr. \*\*\*, datë 12.10.2016, për të ardhurat në periudhën 2008 – 2015, në shumën 6,412,988 lekë; vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 20.1.2017, për llogarinë e pagës në vitet 2005 – 2016.



127. Komisioni ka analizuar dhe përlllogaritur mundësinë dhe ecurinë e deklarimeve të kursimeve të subjektit sipas deklaratave periodike, si dhe deklaratën *Vetting*, si në vijim.

**Tabela nr. 13 – Analiza financiare e ecurisë së kursimeve *cash* ndër vite**

Ne DIPP 2014	470,000
Ne DIPP 2015	400,000
Ne DIPP 2016	540,000
Total cash të kursyera	1,410,000
Total cash të deklaruara ne <i>vetting</i>	1,200,000
<b>Diferenca e cash</b>	<b>210,000</b>

128. Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme për krijimin e gjendjeve *cash* të deklaruara, ndonëse ka rezultuar një diferencë prej 210,000 lekësh (më pak) nga deklarimi në DIPP deri në vitin 2016, në krahasim me deklaratën *Vetting*.

**6. Depozitë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare, në vlerën 215,372 lekë, në emër të bashkëshortes së subjektit**

129. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2012 depozitë në vlerën 200,000 lekë në BKT, në emër të bashkëshortes së tij, me burim kursimet nga paga ndër vite. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar depozitën në fjalë në shumën 211,473 lekë. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar depozitën në fjalë në shumën 214,178 lekë.
130. Në deklaratën e personit të lidhur, në deklaratën *Vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar llogarinë e pagës së saj në BKT, në vlerën 215,372.3 lekë, si dhe ka paraqitur bashkëngjitur kësaj deklarate lëvizjet e llogarisë, nga ku ka rezultuar vlera e sipërcituar. Po ashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, ka rezultuar se llogaria në fjalë është furnizuar nëpërmjet të ardhurave nga paga.
131. Nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika mbi burimin e krijimit të depozitës bankare në analizë dhe as lidhur me deklarimin përkatës.

**KONSTATIME TË TJERA**

**1. Lidhur me vendbanimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite**

132. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se që nga momenti i marrjes së detyrës në vitin 2009 si prokuror ka banuar në pasuritë e ndodhura në adresat si vijon:
133. Në periudhën gusht 2008 – shkurt 2015 ka banuar me qira në apartamentin e ndodhur në qytetin e Sarandës, në adresën Lagjja Nr. \*\*\*, k. \*\*\* i objektit, ndodhur në z. k. \*\*\*. Me pronaren e apartamentit, znj. L.M , subjekti ka nënshkruar kontratën e qirasë nr. \*\*\*, datë 7.3.2012, për periudhë njëvjeçare, në shumën 7,500 lekë në muaj. Ai ka specifikuar se nuk ka paguar qira vetëm katër muaj e, konkretisht, nga muaji prill deri në korrik të vitit 2010, pasi ka qenë i komanduar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, veprim ky i kryer në mirëkuptim të plotë me znj. M. Pavarësisht marrëdhënies kontraktore të dokumentuar për vitin 2012, subjekti ka deklaruar se ka paguar qira rregullisht për të gjithë periudhën e punësimit në qytetin e Sarandës, shumën 7,500 lekë/muaj.
134. Gjatë periudhës shtator 2008 – nëntor 2009, subjekti ka deklaruar se ka qëndruar me familjen e tij në qytetin e Elbasanit, në adresën lagjja “\*\*\*\*”, pall. nr. \*\*\*, banesë e cila aktualisht është vetëm në emër të vëllait të tij, z. Y.A dhe që është analizuar më herët (pasuria nr. \*\*\*)

135. Prej muajit nëntor 2009 e deri aktualisht, subjekti ka deklaruar se banon me familjen e tij (përfshirë nënën dhe motrën<sup>51</sup>) në adresën ndërtesa nr. \*\*\*, hyrja nr. \*\*\*, apt. nr. \*\*\*\* (pasuria nr. \*\*\*, e deklaruar në deklaratën *Vetting*).
136. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë<sup>52</sup>, Elbasan<sup>53</sup>, lidhur me çështje të mundshme të shqyrtuara nga subjekti, me palë pronaren e apartamentit që ai ka deklaruar se ka pasur në përdorim. Këto institucione kanë bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të shqyrtuara nga prokurori Platin Aliçka me palë shtetasen L.M .
137. SPAK-u ka bërë me dije se nuk ka rezultuar ndonjë procedim i regjistruar në emër të znj. M, si dhe nuk ka rezultuar të jetë përfshirë në krimin e organizuar<sup>54</sup>.
138. Për sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me vendbanimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite.

## **2. Lidhur me automjetin tip “\*\*\*\*” të znj. E.A në përdorim edhe nga subjekti i rivlerësimit**

139. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe 3, subjekti ka deklaruar se ka përdorur automjetin me targë TR \*\*\*, në pronësi të motrës së tij znj. E.A dhe me këtë automjet ka dalë vetëm një herë jashtë vendit. Mjeti është blerë sipas kontratës së datës 23.1.2014, të nënshkruar mes znj. E.A dhe shoqërisë “\*\*\*\*”<sup>55</sup> për shitblerjen e automjetit në vlerën 2,400 euro. Pagesa është depozituar në llogarinë bankare të shoqërisë në fjalë sipas mandatpagesës së datës 4.11.2013. Ai ka sqaruar se për të mos bërë dokumente çdo herë që mund t’i nevojitej dhe vetëm për lehtësi dokumentacioni në rast përdorimi nga ana e tij, është bërë specifikimi i tij si përdorues në siguracionin vjetor.
140. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 25.1.2016, subjekti ka deklaruar se motra e tij e kishte blerë automjetin e sipërcituar nga kompania farmaceutike pranë së cilës ishte e punësuar dhe se ai e përdorte atë për të shkuar në punë dhe sa herë që i nevojitej.
141. Pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se si burim për krijimin e kësaj pasurie nga motra kanë shërbyer të ardhurat e saj nga paga. Në këto kushte dhe nisur nga faktet se: (i) motra e subjektit ka pasur detyrimin për deklarimin e pasurisë në cilësinë e personit të lidhur; (ii) duke qenë se vetë subjekti përgjatë procesit të rivlerësimit ka deklaruar se ka përdorur këtë automjet, Komisioni ka vlerësuar të kryejë analizën financiare për përllogaritjen e mundësisë së znj. E.A për blerjen e automjetit në analizë, për sa kohë janë konstatuar policia ku subjekti rezultonte përdorues për periudhën 2014 – 2018, si dhe nisur nga fakti që në momentin e krijimit të kësaj pasurie motra e subjektit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me subjektin dhe ka bashkëjetuar me këtë të fundit e me gjithë familjen. Në analizë janë marrë në konsideratë të ardhurat e saj nga punësimi – duke filluar nga data 30.4.2009 kur ajo ka filluar punë deri në datën 4.11.2013, kur është blerë automjeti në fjalë, - si dhe shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë dhe shpenzime për qiranë e paguar prej

<sup>51</sup> Sipas deklaramit të tij në pyetësorin nr. 3.

<sup>52</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2023.

<sup>53</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2023.

<sup>54</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2023.

<sup>55</sup> Subjekti ka paraqitur dokumentin e llogarisë bankare, ku është pasqyruar transaksioni bankar i blerjes së automjetit me targë TR \*\*\*, certifikata e pronësisë së automjetit me targë TR \*\*\*; kontratë shitjeje e automjetit nr. \*\*\*.

saj për periudhën dhjetor 2007 – tetor 2009, gjatë së cilës nuk ka bashkëjetuar me subjektin (referuar përgjigjeve të subjektit në pyetësonin nr. 4).

142. Nga analiza e kryer nga Komisioni ka rezultuar se znj. E.A ka pasur mjaftueshmëri financiare për blerjen e kësaj pasurie, siç është paraqitur në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 14** – Analiza financiare për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” nga znj. E.A, për periudhën 30.4.2009 – 4.11.2013

Të ardhura nga paga E.A	1,534,925
<b>Total të ardhura</b>	<b>1,534,925</b>
Shpenzime jetese	621,388
Shpenzime udhëtimi	66,603
Shpenzime qiraje	24,000
Blerje makinë	336,264
Likuiditete	65,628
<b>Total shpenzime</b>	<b>1,113,883</b>
<b>Rezultati në datë 4.11.2013</b>	<b>421,042</b>

143. Gjithashtu, vlen të theksohet se edhe nëse do të vlerësohej mundësia financiare në raport me të gjithë familjen, nisur nga konstatimet në pikën 2.8 (tabela nr. 11), sërish do të rezultonte një mjaftueshmëri financiare me burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.
144. Përpos detyrimit të subjektit për deklarimin e kësaj pasurie në përdorim, Komisioni ka konstatuar se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në datën 8.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me nënën, motrën dhe vëllain. Për efekt të këtij ligji, sipas dispozitave të cituara më sipër, personat e mësipërm, për shkak të qenies në të njëjtën certifikatë familjare, konsiderohen persona të lidhur që kanë pasur detyrimin për të paraqitur deklaratën e pasurisë *Vetting* bashkë me gjithë dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre – ndonëse nuk janë konstatuar pamundësi financiare as nga ana e personave të lidhur me subjektin në raport me pasuritë e tyre.
145. Nisur nga sa më sipër, Komisioni e ftoi subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me deklarimin e pasaktë/të paplotë në deklaratën *Vetting*, për shkak të mosdeklarimit të pasurisë së disponuar nga motra e tij dhe as të përdorimit prej tij të automjetit në pronësi të saj, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

146. Subjekti ka parashtruar se nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti, pasi sipas tij, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, qëllimi i rivlerësimit të pasurisë është kontrolli i pasurive që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të dhe, sipas tij, automjeti në fjalë nuk ka qenë në përdorim të tij në kuptim të këtij përcaktimi ligjor. Subjekti ka sqaruar se nuk e ka pasur në përdorim të pandërprerë automjetin në pronësi të motrës së tij, por vetëm një herë për të dalë jashtë vendit dhe ndonjëherë kur e ka pasur të nevojshme. Gjatë periudhës që ai ka qenë i emëruar me detyrë në Sarandë, automjeti përdorej nga motra e tij, e cila jetonte në Tiranë. Subjekti është shprehur se nuk ka pasur si qëllim për ta fshehur përdorimin, pasi ai vetë e ka deklaruar këtë fakt në procesverbalin e vitit 2016, të mbajtur nga ILDKPKI-ja.
147. Lidhur me konstatimin e Komisionit se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” në datën 8.10.2016, subjekti i

rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me nënën, motrën dhe vëllain e, për rrjedhojë, ka bërë deklaram të pasaktë/të paplotë në deklaratën *Vetting*, subjekti ka parashtruar se në konsultim edhe me nëpunës të ILDKPKI-së i kanë bërë me dije se nuk ishte i nevojshëm deklarimi për nënën, motrën dhe vëllain, për sa kohë në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ata nuk kanë qenë pjesë e përbërjes familjare.

148. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se personat e lidhur nuk kanë shtuar asnjë pasuri gjatë viteve 2013 – 2016, si dhe ka bërë me dije se prej vitit 2021 motra e vëllai i tij jetojnë në një apartament me qira, duke vënë në dispozicion edhe kontratën e qirasë së datës 10.5.2021.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

149. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, çmon të marrë në konsideratë faktet se: (i) nga hetimi i kryer lidhur me përdorimin e automjetit në analizë, si dhe bazuar në të dhënat e rezultuara nga sistemi TIMS nuk u konstatuan lëvizje të shpeshta, por vetëm një udhëtim jashtë vendit; (ii) nuk ka një referencë/apo të dhënë tjetër për të provuar shpeshësinë e përdorimit të automjetit, përveçse specifikimit si përdorues në siguracionin vjetor, kohë kur subjekti ka qenë me detyrë në qytetin e Sarandës, ndërkohë që motra e tij jetonte në Tiranë dhe mund t'i nevojitej për përdorim vetjak; (iii) nga hetimi i Komisionit nuk u ngritën dyshime për pasuri të fshehur, pasi: (a) u provua burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie nga të ardhurat nga puna e motrës së subjektit; (b) vlera e këtij automjeti ishte e ulët; (c) gjithsesi edhe subjekti në momentin e blerjes dispononte të ardhura më se të mjaftueshme për ta blerë këtë mjet, nëse qëllimi do të kishte qenë për ta përdorur vetë atë.
150. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i përdorimit të automjetit ndonëse përbën një pasaktësi në deklarim, nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “a”, pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë motra e subjektit nuk rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë në analizë, duke u përjashtuar çdo dyshim i mundshëm lidhur me burimin e krijimit, të disponimit dhe të të drejtave mbi këtë autoveturë.
151. Lidhur me detyrimin për deklarimin e pasurive të personave të lidhur, Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaramet periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet në seancë dëgjimore, arsyeton se: Nëna, motra dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit bëjnë pjesë në rrethin e personave të lidhur, të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kanë pasur detyrimin që të deklaronin pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, të ardhurat, detyrimet financiare dhe/apo interesa të tjera private.
152. Nga hetimi administrativ kryesisht rezultoi se personat e lidhur nuk kanë shtuar pasuri gjatë viteve 2013 – 2016, për rrjedhojë duken bindëse shpjegimet e subjektit se nuk mund të konsiderohet si mosdeklarim i qëllimshëm për të mbuluar përfitime të paligjshme. Megjithatë, trupi gjykues çmon se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting*.

153. Nëse analizojmë deklarin e pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimit në pikat 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, rezulton se subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarin dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen nëse kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose nëse nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur, si dhe duhet të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Por, duke qenë se shpjegimet e dhëna dhe dokumentacioni i përcjellë nga subjekti krijojnë mundësi për të verifikuar që deklarinet e tij pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike, lidhur me krijimin e pasurive që personat e lidhur zotërojnë në bashkëpronësi me subjektin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, provohet burimi i krijimit të këtyre pasurive, si dhe për shkak se nuk ka kontradikta mes deklaratës *Vetting*, deklarimeve periodike vjetore, deklarimeve përgjatë procesit të rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ, Komisioni vlerëson se ky deklarin i pasaktë (ndoshta për moskuptimin e plotë të ligjit dhe të formularit të deklaratës *Vetting*) nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për aq sa Komisioni hetoi personat e lidhur dhe nuk konstatoi problematika me pasuritë e tyre dhe të burimeve financiare relative, që do të mund të lidheshin apo të ndikonin procesin e rivlerësimit të subjektit.

### **3. Lidhur me udhëtimet e subjektit jashtë vendit, me automjete në pronësi të shtetasve të tjerë**

154. Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i kryer *online* në sistemin informatik të AMF-së, është konstatuar se subjekti dhe familjarët e tij kanë rezultuar përdorues të automjeteve me targa: TR \*\*\*, në pronësi të znj. E.A, motrës së subjektit; AA \*\*\*, në pronësi të shtetasit E.Gj ; KO \*\*\* në pronësi të shtetasve A dhe E.A; SH \*\*\*, në pronësi të shtetasit H.M.D.
155. Lidhur me sa më sipër, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se shtetasi E.Gj është shok i vëllait të tij. Shtetasi A.A është kushëriri i dytë i subjektit, ndërsa E.A është bashkëshortja e shtetasit A.A. Në lidhje me shtetasin H.D , subjekti ka deklaruar se ai është taksist dhe mjeti i tij është përdorur rastësisht dhe pa asnjë lloj njohjeje të mëparshme nga ana e subjektit, për një udhëtim vajtje-ardhje brenda të njëjtës datë, në Mal të Zi.
156. Subjekti ka deklaruar se nuk ka hetuar asnjë çështje apo kallëzim ku të kenë qenë të përfshirë shtetasit e mësipërm. Në mbështetje të deklarin të tij, ai ka paraqitur vërtetimet e Prokurorive pranë të cilave ka ushtruar detyrën, si dhe pasaportat e mëparshme të tij dhe të familjarëve.
157. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit janë përcjellë të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS, nga të cilat ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë udhëtuar jashtë territorit të Shqipërisë me mjetet e sipërcituara.
158. Nisur nga informacionet e administruara përgjatë hetimit administrativ, si dhe verifikimet e kryera në sistemin TIMS, në raport edhe me përdorimin e mjeteve në pronësi të personave të tretë dhe të përdorura nga subjekti dhe personat e lidhur (përfshirë edhe ato automjete me të cilat kanë udhëtuar jashtë shtetit dhe që janë drejtuar nga të tjerë shtetas), Komisioni ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë<sup>56</sup> dhe Elbasan<sup>57</sup>, pranë të cilave ka ushtruar detyrën subjekti i rivlerësimit lidhur me ekzistencën e konfliktit të

<sup>56</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2023.

<sup>57</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2023.

mundshëm interesi, midis subjektit dhe pronarëve të këtyre automjeteve. Këto institucione kanë bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të hetuara nga subjekti i rivlerësimit me palë shtetasit e sipërcituar.

159. Komisioni i është drejtuar gjithashtu edhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila ka bërë me dije se nuk disponohen të dhëna që shtetasit, për të cilët ishte kërkuar informacion lidhur me rekorde kriminale të mundshme, të ishin përfshirë në krimin e organizuar<sup>58</sup>.
160. Nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me automjetet e përdorura nga subjekti për udhëtimet e kryera jashtë shtetit, për sa kohë ato kanë qenë sporadike të përdorura vetëm nga një herë dhe jo në përdorim të vazhdueshëm prej tij.

## **REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE**

161. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në tabelën në vijim, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në këtë analizë janë paraqitur:
162. Pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruara në vitin përkatës të kryerjes së investimit.
163. Të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëngjitur deklaratës *Vetting*.
164. Shpenzimet jetike janë përlllogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT-i.
165. Shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit.
166. Shpenzimet e mobilimit të apartamentit të subjektit dhe shkollimit të fëmijëve janë konsideruar sipas deklaratimeve të tij në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.
167. Gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.
168. Kursi i këmbimit i përdorur për të gjitha investimet/shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë<sup>59</sup>.
169. Analiza është kryer duke filluar nga viti 2008, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm pozitiv siç është detajuar në tabelën që vijon:

---

<sup>58</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 26.6.2023.

<sup>59</sup> [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

## Analiza financiare e periudhës 2008 – 2016

#NAME?	Deri në 2007	1.1.2008-31.7.2008	1.8.2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	-625,433	-195,908	322,650	6,265,423	129,376	-409,354	131,384	551,179	863,106	82,000	614,335
Banesë të përfitur nga EKB, Elbasan, kati 1											
Apartament banimi në Tiranë/ 85m2				6,309,820							
Fiat Croma	300,000										
Volksägen Golf								336,264			
<b>Ndryshim në likuiditet</b>	-925,433	-195,908	322,650	-44,397	129,376	-409,354	131,384	214,915	863,106	82,000	614,335
<b>Likuiditete ne total</b>	<b>261,396</b>	<b>65,487</b>	<b>388,137</b>	<b>343,741</b>	<b>473,117</b>	<b>63,763</b>	<b>195,146</b>	<b>410,061</b>	<b>1,273,167</b>	<b>1,355,167</b>	<b>1,969,502</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>5,870,573</b>	<b>324,706</b>	<b>-1,083,543</b>	<b>-518,652</b>	<b>-680,350</b>	<b>-145,546</b>	<b>-671,698</b>	<b>-196,937</b>
Hua nga A.R				4,115,100							
Shlyerje detyrimi ndaj A. R							-419,160	-560,840			
Kredi për shlyerjen e huasë 10,000 (969,000) 18.6.2010					969,000						
Shlyerje detyrimi principal I kredise 969,000 leke					-44,294	-83,543	-99,492	-119,510	-145,546	-171,698	-196,937
Hua nga E.K				355,473							
Shlyerje detyrimi ndaj E.K				-100,000	-600,000						
Hua nga D.P.											
Shlyerje detyrimi ndaj D.P				1,500,000		-1,000,000				-500,000	
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>-625,433</b>	<b>-195,908</b>	<b>322,650</b>	<b>394,850</b>	<b>-195,329</b>	<b>674,189</b>	<b>650,036</b>	<b>1,231,529</b>	<b>1,008,652</b>	<b>753,698</b>	<b>811,272</b>
<b>TE ARDHURA deklaruar</b>	<b>0</b>			<b>0</b>	<b>50,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>150,000</b>
Te ardhura nga dhurata per lindje					50,000						150,000
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	<b>11,590,077</b>	<b>775,938</b>	<b>861,265</b>	<b>3,685,495</b>	<b>2,572,146</b>	<b>2,852,794</b>	<b>2,774,523</b>	<b>3,618,887</b>	<b>4,456,974</b>	<b>4,720,491</b>	<b>2,986,832</b>
Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë (OPGI)	130,605										
Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan	2,044,737									829,749	1,108,105
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (OPGI)	2,777,946	403,618	419,324								
Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë				903,860	901,492	968,048	917,283	968,711	1,137,385	196,885	
Te ardhura nga B/shortja M. A sh.p.k			150,320	612,392	261,266	660,684	717,225	734,961	811,907	870,493	364,765
Te ardhura nga dhurimi				1,234,530							
Te ardhurat nga pensioni i nenes se SR	750,004	93,968	72,580	183,160	191,274	198,684	206,394	214,404	220,254	223,997	227,233
Te ardhurat e motres				309,008	753,011	460,989	353,161	885,765	1,198,984	1,644,769	458,898
Te ardhurat e vella	2,045,385	278,352	219,041	442,545	465,103	564,389	580,460	811,008	1,082,431	951,832	825,833
Te ardhurat nga interesat bankare b/sh								4,038	6,013	2,766	1,998
Te ardhura nga trashëgimia nga gjyshi ne amerike (ne testament)	3,841,400										
<b>SHPENZIME</b>	<b>3,730,424</b>	<b>318,780</b>	<b>518,620</b>	<b>2,185,951</b>	<b>1,025,463</b>	<b>1,089,320</b>	<b>1,235,131</b>	<b>1,054,466</b>	<b>1,630,019</b>	<b>1,675,999</b>	<b>2,019,769</b>
shpenzime jetese	3,712,288	318,780	261,855	683,100	762,795	819,720	837,288	846,144	1,319,988	1,345,656	1,528,098
Shpenzime qeraje			37,500	90,000	60,000	90,000	90,000	90,000	90,000	15,000	
Shpenzime mobilimi				1,234,530							
Shpenzime arsimi per djalin									60,000	90,000	
Shpenzime transporti si I punesuar ne Elbasan										50,000	60,000
Shlyerje detyrimi i interesave te kredi dt.18.6.2010 shuma 969,000 leke					79,099	158,855	140,179	118,322	85,773	54,138	27,363
Shpenzime per lindjes se femijes				50,000							150,000
Shpenzime udhetimi (TIMS)	18,137		219,265	178,321	73,569	20,745	167,664	0	74,258	121,205	254,308
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>8,485,086</b>	<b>653,066</b>	<b>19,995</b>	<b>1,104,694</b>	<b>1,742,012</b>	<b>1,089,285</b>	<b>889,356</b>	<b>1,332,893</b>	<b>1,818,302</b>	<b>2,290,794</b>	<b>155,791</b>
<b>DIFERENCA E PAMBULUAR</b>	<b>0</b>										

170. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerëson se z. Platin Aliçka ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuara ku rezultoi të ishte i përfshirë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. Për sa i përket pamundësisë financiare të huadhënësit E. K, në vlerën 330,377 lekë, trupi gjykues ka konstatuar se gjithsesi ato nuk do të kishin ndonjë efekt përcaktues në vendimmarrjen e Komisionit, duke pasur parasysh masën e balancës negative, si dhe faktin se balanca negative e rezultuar mbulohet me disponibilitetin e familjes së subjektit, i deklaruar si burim në deklaratën *Vetting*.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

171. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, pa përgjigjen e njërit prej organeve ligjzbatuese – me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Platin Aliçka.
172. Me shkresën e datës 12.10.2017 është bërë me dije se edhe pas mbërritjes së përgjigjes së munguar nuk janë konstatuar të dhëna apo elemente të reja, që mund të ndryshonin konstatimin e mësipërm.
173. Gjithashtu, në vijim, nëpërmjet shkresave të datave 28.3.2018, 9.8.2023 dhe 16.8.2023, organet ligjzbatuese i kanë bërë me dije Komisionit se nga verifikime të mëtejshme të kryera nuk janë disponuar të dhëna për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme.
174. Po ashtu, në vijim të kërkesës së Komisionit për një përditësim e deklasifikim të raportit të tyre, AKSIK-ja, me shkresën e datës 21.8.2023 ka përcjellë pranë Komisionit raportin e sipërcituar, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.8.2023, të KDZH-së.
175. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në të dhënat që disponohen, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Platin Aliçka arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ai ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk ka bërë deklaramë të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

#### **C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale nga KLP-ja**

176. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Platin Aliçka, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
177. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
178. Raporti i përcjellë nga KLP-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, si: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.



179. Nga të dhënat që ndodhen në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit Platin Aliçka.
180. Prokuroria e Përgjithshme ka administruar një material hetimor me kallëzues shtetasin S.Th kundër prokurorit Platin Aliçka, të cilin me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2015, e ka dërguar për trajtim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
181. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit S.Th , i cili ka pretenduar se prokurori Platin Aliçka ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me disa kallëzime të bëra nga shtetasi Th në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë kundër shtetasve Sh. H dhe S.Q. Vendimi i dhënë nga prokurori Platin Aliçka është ankimuar në të dyja shkallët e gjyqësorit nga shtetasi S.Th – dhe të dyja gjykatat kanë vendosur shfuqizimin e vendimit të prokurorit.
182. Shtetasi i mësipërm ka paraqitur kallëzim penal kundër prokurorit Platin Aliçka, duke parashtruar se prokurori ka vendosur padrejtësisht mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2013, ndaj shtetasit M.K. Në përfundim të hetimeve është vendosur pushim i procedimit penal lidhur me kallëzimin ndaj prokurorit. Ky vendim pushimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 30.4.2015. Kundër këtij vendimi nuk është bërë ankim.
183. Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, për periudhën viti 2006 – 2020, ka rezultuar se ka dy ankesa:
- 183.1 Ankesa nr. \*\*\*, viti 2015, e shtetasit S.Th , të cilën Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2015, e ka dërguar për trajtim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sikurse është trajtuar më sipër.
- 183.2 Ankesa nr. \*\*\*, viti 2020, e shtetas A.C . Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2020, Prokuroria e Përgjithshme i ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ankesën e shtetasit A.C . Kjo shtetase ka kërkuar përjashtimin e prokurorit Platin Aliçka nga hetimi i disa kallëzimeve penale të bëra prej saj. Kjo kërkesë për përjashtim është bërë pasi prokurori Platin Aliçka kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal për këto kallëzime penale.

## **C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni**

184. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin përkatës bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku dhe nga organet e tjera ligjzbatuese, si dhe ka analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
185. Nga raporti i vlerësimit të aftësive profesionale ka rezultuar se përgjithësisht nuk janë konstatuar problematika në lidhje me tri dokumentet ligjore të depozituara prej subjektit dhe me pesë dosjet e shortuara. Ndërsa, lidhur me një ankesë dhe një kallëzim të bërë ndaj subjektit, nga shtetasi S.Th është konstatuar sa vijon:

186. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2013, lidhur me kallëzimin e shtetasit S. Th. ndaj shtetasit M. K, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” (neni 199/a i Kodit Penal). Në përfundim të hetimeve për këtë procedim, subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.7.2011, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Pas ankimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.6.2013, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të prokurorit<sup>60</sup>. Pas kryerjes së detyrave të lëna nga gjykata, subjekti, me kërkesën e datës 4.11.2013, ka kërkuar sërish pushimin e çështjes. Vendimi i tij është ankimuar sërish dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.4.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit për shkak të moszbatimit të detyrave të lëna nga Gjykata. Në vijim, gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.2.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 4.11.2013, të dhënë nga subjekti.
187. Gjithashtu, i njëjti shtetas ka kallëzuar edhe shtetasit M.K dhe H.Gj , kallëzim për të cilin subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.7.2012, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim është prishur nga gjykata, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.12.2012, ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve (kryerjen e ekspertimit grafik të nënshkrimeve, si dhe administrimin e provave shtesë).
188. Pas ankimit nga prokurori/subjekti, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. \*\*\* datë 26.3.2013, ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, datë 5.12.2012. Në vijim, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.8.2013, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit, duke arsyetuar ndër të tjera se ekspertimi grafik nuk mund të kryhej pasi nuk disponoheshin modele të lira shkrimi. Nënshkrimi ishte konfirmuar nga vetë personi. Po ashtu, nga sistemi TIMS është konfirmuar se shtetasi ka qenë në Shqipëri, ndryshe nga sa kishte pretenduar kallëzuesi. Vendimi i subjektit është lënë në fuqi nga gjykata me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.12.2014. Ndërsa, Gjykata e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.4.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm: “Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 28.8.2013, të Prokurorisë dhe kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve, sipas detyrave të lëna me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.12.2012”.
189. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, lidhur me sa më sipër subjekti ka shpjeguar se në kushtet kur nuk ka pasur asnjë të dhënë konkrete për kryerjen e një veprë penale, por vetëm pretendime nga kallëzuesi, nga ana e tij është vendosur mosfillimi i procedimit penal bazuar në nenet 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, pasi mungonin të dhënat që krijojnë dyshimin për kryerjen e veprës penale mbi prova konkrete apo ngjarje konkrete. Në materialin kallëzues dhe aktet bashkëlidhur parashtroheshin pretendime të kallëzuesit të mbështetura në akte të institucioneve kompetente për hartimin e tyre si detyrim ligjor, mbi të cilat pretendohet ndërtim i paligjshëm. Materiali kallëzues nuk kishte asnjë akt të institucionit kompetent të Bashkisë Sarandë, që të provonte ankim administrativ për shkelje të lejes së ndërtimit të pretenduar në kallëzim dhe të kishte një dyshim për veprën penale, por kishte aktet e detyrueshme ligjore të administratës së bashkisë.
190. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se periudha kur ushtrohet e drejta e kallëzimit penal përkon me kohën kur çështja ishte bërë konflikt gjyqësor dhe ishte shqyrtuar/zgjidhur nga gjykata kompetente. Nga kallëzuesi nuk disponohej një vendim gjyqësor civil për sigurim padie për

---

<sup>60</sup> Duke u shprehur se: “... prokurori duhet të hetonte dhe të verifikonte në lidhje me dhënien e lejes së ndërtimit në favor të shoqërisë “A” sh.p.k., sipërfaqen e ndërtimit dhe faktin se nëse ka ndërtuar jashtë kondicionit urban dhe nëse ka ndërtuar mbi truall publik duke cenuar kështu interesat e shtetit”.

ndalim punimesh (që është vendimi gjyqësor më i ngutshëm, brenda 5 ditëve). Mungesa e ankimit administrativ gjyqësor për sigurim padie nga kallëzuesi dhe nga ana tjetër ekzistenca e lejes së ndërtimit – dokumentacion ky i paraqitur edhe në gjykatë – ishin të dhëna mbi të cilat ishte bazuar ai për marrjen e vendimit të mosfillimit.

191. Gjithsesi, edhe pasi janë kryer detyrat (hetimore) të urdhëruara nga gjykata, ka rezultuar se nuk ishte kryer një ndërtim i paligjshëm, referuar edhe aktit të ekspertimit topografik. Sipas shpjegimeve të subjektit, çështja në fjalë ishte rikthyer për rihetim për procedurë jo për zgjidhjen në themel, pasi të dy trupat gjykues kanë gjetur të drejtë vendimin e prokurorisë.
192. Për sa më sipër, Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, si dhe shpjegimeve të subjektit, ka konstatuar se nga ana e tij nuk janë marrë masa për kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore për të verifikuar pretendimet e kallëzuesit. Ky konstatim gjen mbështetje edhe në analizë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila ka urdhëruar që të regjistrohet procedim penal, si dhe kryerjen e një akti ekspertimi topografik, me qëllim verifikimin e objektit të kallëzimit penal në fjalë, në funksion të zbardhjes së ngjarjes së dyshuar.
193. Në këto kushte, Komisioni e ka ftuar subjektin të japë shpjegime lidhur me marrjen e një vendimi nga ana e tij për mosfillimin e procedimeve penale nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, duke mos i kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore/detyrat e lëna nga gjykata lidhur me çështjet e sipërpërshkruara (sikurse kanë konstatuar dhe janë shprehur edhe gjykatat në të dyja shkallët).

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

194. Subjekti i ka qëndruar të njëjtave shpjegime të dhëna edhe përgjatë hetimit administrativ. Lidhur me procedimin nr. \*\*\*, subjekti ka rishpjeguar se në marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal është bazuar në faktin se rrethanat e faktit nuk formonin elementët e figurës së veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Çështja e vlerësimit të fakteve ka qenë e lidhur me aspekte ligjore të konceptit të kësaj vepre penale dhe nuk ka pasur nevojë të shqyrtoheshin më tej çështjet faktike, pasi pavarësisht nëse do të kishte shtesë volumesh mbi projektin e miratuar, ky fakt nuk e bënte ndërtimin të paligjshëm dhe shkelja përbënte në të gjitha rastet kundërvajtje administrative. Me ligjin nr. 176/2014 është shtuar si element i anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, edhe rastin kur ndërtimi kryhet në shkelje të rëndë të lejes së ndërtimit. Nëse kjo dispozitë do të ishte në fuqi në kohën kur është kryer ndërtimi, atëherë sipas subjektit do të duhej të kryhej një akt ekspertimi teknik ashtu siç ka vendosur gjykata në shfuqizimin e vendimit të rastit në fjalë.
195. Ndërsa lidhur me procedimin nr. \*\*\*, subjekti ka parashtruar se nga kallëzimi i bërë nga shtetasi S. Th organit të akuzës i rezultonte e qartë se nuk kishte të dhëna që të ishin konsumuar elementet e ndonjë vepre penale. Pretendohej se palët e treta mund të mos kishin qenë prezent në momentin e hartimit të prokurës për avokatin e tyre. Për këtë pretendim, kallëzuesi nuk referohet tek asnjë e dhënë, por vetëm përmendej fakti se *“kemi dëgjuar se nuk kanë qenë në Shqipëri”*. Për të regjistruar një procedim penal duhet të ekzistojnë fakte të dokumentuara apo të paraqiten të dhëna që të çojnë në përfundimin se ekziston dyshimi për konsumim të një vepre penale, por në asnjë rast regjistrimi i procedimit penal nuk mund të mbështetet në supozime. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal.

196. Nga hetimet e kryera, pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore sipas urdhërimit nga Gjykata, u arrit të pyetet shtetasi P. S dhe ai konfirmoi mbi faktin që avokati mbrojtës është zgjedhur prej tij, u hoq dorë nga prokuroria për kryerjen e ekspertimit grafik të shkrimit.
197. Kjo edhe me argumentin se akti i përfaqësimit për avokatin është vlerësuar i drejtë nga Gjykata Civile dhe në harmoni me provat e tjera. Pretendimet e ngritura nga kallëzuesi gjatë hetimeve paraprake nuk janë ngritur në gjykim civil, pasi nuk ka pasur prova.
198. Në bazë të nenit 71 të Kodit të Procedurës Penale gjykata penale është e detyruar të marrë për bazë faktin penal të konstatuar në gjykimin civil. Nga gjykimi civil nuk ka rezultuar që kallëzuesi të ketë ngritur pretendime për ekzistencën e një prokure të falsifikuar për avokatin mbrojtës të palës së tretë në gjykim. Duke marrë për bazë edhe këtë fakt është vendosur për pushimin e çështjes penale. Subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur prishje të vendimit të prokurorisë dy herë, por vetëm një herë dhe gjykata nuk ka marrë vendim të mbështetur në ligj.
199. Vendimi i pushimit të çështjes me argumentimin e bërë nga prokuroria është gjetur i drejtë nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është shfuqizuar nga Gjykata e Apelit.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

200. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me procedimin nr. \*\*\*, ka konstatuar se pasi janë kryer detyrat e gjykatës ka rezultuar se nuk kishte ndërtim të paligjshëm referuar edhe aktit të ekspertimit topografik. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. \*\*\*, viti 2014, ka prishur vendimin nr. \*\*\* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, i cili kishte lënë në fuqi vendimin e pushimit të prokurorit për procedimin penal nr. \*\*\* dhe ka urdhëruar rigjykimin në atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Vendimi i pushimit, marrë nga subjekti për procedimin penal nr. \*\*\*, është lënë në fuqi pasi është gjykuar nga një tjetër trup gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin e saj nr. \*\*. Pas ankimit, Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. \*\*\*, viti 2015, ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ndaj rezulton se është prishur për procedurë vendimi i gjykatës e jo për zgjidhjen në themel. Pra, nuk kemi prishje të vendimit të prokurorisë dy herë, por vetëm një herë dhe gjykata nuk ka marrë vendim të mbështetur në ligj. Në përfundim, të dy trupat gjykues kanë gjetur të drejtë vendimin e prokurorisë.
201. Ndërsa, lidhur me procedimin nr. \*\*\*, trupi gjykues çmon se jo në çdo rast procesi civil kushtëzohet nga ai penal, sipas një vlerësimi apriori. Rast pas rasti, nga gjykatat do të duhet të vlerësohen fazat në të cilat ndodhen të dyja proceset apo edhe fakti nëse në të dyja proceset mund të shtrohen për zgjidhje përgjegjësia subjektive (civile dhe penale) e personit që ka kryer falsifikimin.
202. Pavarësisht se në rezultate ishte konstatuar se vendimi i dhënë nga subjekti ishte prishur 2 herë nga gjykatat, trupi gjykues, pas analizimit të shpjegimeve të tij mbi dinamikën e hetimeve dhe të dhënat e grumbulluara nga hetimi deri në fazën e marrjes së vendimit nga subjekti, bazuar edhe në arsyetimin e bërë nga Gjykata e Apelit, ka arritur në përfundimin se shkaku i prishjes së vendimit lidhej me vlerësimin e provave nga ana e subjektit, i cili ka pushuar çështjen penale në fjalë. Konkretisht, për heqjen dorë nga kryerja e aktit të ekspertimit grafik të shkrimit ka shërbyer edhe fakti që është Gjykata Civile ajo që vlerëson provat e, në rastin konkret, ka rezultuar se prokura është vlerësuar si e vlefshme nga organi kompetent që ka detyrimin ligjor që të bëjë vlerësimin e saj.

203. Përpos sa më sipër, trupi gjykues çmon të marrë në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur në vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, nga Gjykata Kushtetuese, ku, ndër të tjera, citohet se: *“...Opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokuroret, të cilat mund të konsiderohen si thjesht të pasakta nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. ... Është shumë e rëndësishme që ... d) vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”*.
204. Në këtë këndvështrim, në lidhje me konstatimin për prishjen e vendimeve të pushimit dhe/apo kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme, siç është trajtuar më sipër, Komisioni vlerëson se në referencë të kuadrit ligjor të zbatueshëm, vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje të caktuar nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që lidhet me vlerësimin e çmimit e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të subjektit të rivlerësimit. Në rastin konkret, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të shpalosur si pjesë e detyrës së prokurorit, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij.

### DENONCIME NGA PUBLIKU

205. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Platin Aliçka janë paraqitur 5 denoncime nga publiku, njëri prej të cilëve është paraqitur dy herë nga i njëjti denoncues. Komisioni, me qëllim vlerësimin e aspektit etik dhe profesional, analizoi të gjitha denoncimet e depozituara, së bashku me materialet përkatëse, duke konstatuar se: (i) disa prej tyre nuk përmbanin elemente/referenca konkrete lidhur me rrethana specifike, që do të mundësonin analizimin e akteve përkatëse; (ii) disa denoncime prej tyre nuk kishin lidhje me aktivitetin profesional të subjektit; (iii) ndërkohë që janë shqyrtuar të gjitha denoncimet e tjera lidhur me të cilat është konstatuar sa vijon:

#### **1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2018, nga një shtetas anonim**

206. Denoncuesi ka ngritur pretendime ndaj disa gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndërmjet tyre edhe ndaj prokurorit Platin Aliçka, për të cilin ka pretenduar se ka pushuar çështjen e kallëzuar prej tij, duke mos kryer hetime.
207. Nga shqyrtimi i dosjes së administruar për çështjen objekt denoncimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<sup>61</sup>, ka rezultuar se çështja në fjalë është regjistruar në Prokurori në datën 3.5.2016, nr. \*\*\* procedimi, bazuar në referimin e Komisariatit të Policisë për veprën penale “Vetëgjyqësi”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Referimi është bërë për shkak se shtetasi Y. M. ka pretenduar se shtetasi H. M. ka salduar derën e banesës së tij. Pas hedhjes së shortit, çështja i është caktuar subjektit të rivlerësimit me urdhrin e datës 9.3.2016. Subjekti, në datën 3.5.2016, ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore. Nga aktet e këqyrura dhe ato të administruara gjatë hetimit penal, ka rezultuar se shtetasit Y. M. dhe H. M. kanë qenë në konflikt gjyqësor civil<sup>62</sup> lidhur me një pronë.

<sup>61</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2023.

<sup>62</sup> Sipas shkresës së datës 3.3.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

208. Një ndër veprimet hetimore të urdhëruara nga prokurori Aliçka ka qenë edhe ekspertimi topografik, sipas vendimit të datës 6.6.2016, nga i cili është konkluduar se shtetasi Y. M. nuk ka rezultuar pronar i pasurisë objekt hetimi.
209. Në përfundim të hetimeve, subjekti, me vendimin e datës 14.6.2016, ka arsyetuar ndër të tjera se nga vlerësimi i të gjitha provave nuk provohet kryerja e veprës penale nga personat nën hetim. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 328/1, shkronja “b”, e cila parashikon respektivisht pushimin e çështjes në rastin kur *“fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”*, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit. Ky vendim nuk është ankimuar<sup>63</sup>.
210. Nisur nga sa më lart, duke vlerësuar përmbajtjen e denoncimit në fjalë në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, trupi gjykues çmon se nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të tij.

## **2. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2019, nga shtetasi I.M**

211. Denoncuesi ka paraqitur dy denoncime me të njëjtën përmbajtje, me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka pushuar hetimin në mënyrë të padrejtë.
212. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar<sup>64</sup> për çështjen objekt denoncimi ka rezultuar se bazuar në referimin e Komisarariatit të Policisë Elbasan për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë 5.4.2018.
213. Nga shqyrtimi i fashikullit hetimor ka rezultuar se duke qenë se kjo çështje ishte hetuar më parë bazuar në kallëzimin e datës 21.3.2018 nga shtetasi I. M., me procesverbalin e datës 21.5.2018, subjekti ka administruar akte nga materiali hetimor nr. \*\*\*, datë 15.3.2018, vendimi i mosfillimit i datës 21.3.2018, së bashku me kallëzimin e shtetasit I. M dhe materiale të fashikullit hetimor. Nga shqyrtimi i tyre është konkluduar se parashtraheshin të njëjtat fakte dhe pretendime. Në këto kushte, prokurori P. Aliçka, në datën 2.7.2018, ka vendosur pushimin e çështjes dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2018, ka njoftuar kallëzuesin mbi vendimin e marrë.
214. Në përfundim të analizimit të dokumentacionit të administruar nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi në veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Pretendimet e denoncuesit për pushimin e padrejtë të çështjes i referohen themelit të çështjes, çka del jashtë kompetencave dhe misionit të Komisionit, duke mos i përmbushur kësaj kushtet e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

## **3. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019, nga shtetasi Gj.Gj**

215. Denoncuesi ka ngritur pretendime ndaj disa gjyqtarëve e prokurorëve, ndërmjet tyre edhe ndaj subjektit të rivlerësimit Platin Aliçka, duke parashtruar se ata janë të korrumpuar dhe kanë dhënë vendim të padrejtë.

<sup>63</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>64</sup> Po aty.

216. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar<sup>65</sup> ka rezultuar se denoncuesi ka pasur mosmarrëveshje me shtetasen N. P. lidhur me pronësinë e një sipërfaqeje toke në posedim të tij. Ai ka paraqitur disa kallëzime, ku ka pretenduar të drejta pronësie, të cilat kanë passjellë një seri procesesh gjyqësore nga shkalla e parë deri në Gjykatën e Lartë. Në të gjitha rastet ka rezultuar se është vendosur pushimi i çështjes<sup>66</sup>.
217. Subjekti është caktuar për hetimin e çështjes objekt denoncimi me urdhrin e datës 3.11.2016, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Elbasan. Në datën 21.11.2016, ai ka urdhëruar të kryhet regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal. Pas kryerjes së ekspertimit teknik të ndërtimit, nga eksperti është konkluduar se për ndërtimin që po kryhej nuk kërkohej leje ndërtimi. Më pas, me vendimin e datës 16.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të pushojë ndjekjen penale për veprën penale të dyshuar (“Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal). Në vijim, Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.6.2018, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, duke u rikryer akt ekspertimi. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.9.2018.
218. Pas kryerjes së detyrave të lëna nga gjykata, subjekti, me vendimin e datës 12.12.2018, veç faktit që ndërtimi i kryer nuk kishte nevojë për leje, ka arsyetuar se për periudhën e kryerjes së ndërtimit objekt kallëzimi, në datën 22.12.2016 është miratuar ligji nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie” dhe në referencë të fakteve dhe të këtij ligji ka vlerësuar të pushojë çështjen në fjalë dhe me kërkesën e datës 23.12.2018 i ka kërkuar gjykatës pushimin e çështjes. Kjo kërkesë është pranuar nga gjykata, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.4.2019, ka vendosur pushimin e çështjes për shkak se faktet nuk parashikoheshin nga ligji si vepër penale/apo ndjekja penale ishte amnistuar.
219. Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2023, është bërë me dije për Komisionin se vendimi i mësipërm është ankimuar nga kallëzuesi (denoncuesi) dhe dosja ndodhet në Gjykatën e Lartë, ku nuk ka ende një vendimmarrje.
220. Në përfundim të shqyrtimit të akteve të përshkruara e analizuara më sipër, nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi në veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë: (i) hapi hetimor për kryerjen e një akti ekspertimi ishte ndërmarrë nga subjekti prej fazës fillestare; (ii) kthimi i dosjes (vetëm) për rikryerjen e një tjetër ekspertimi, i cili gjithsesi ka mbërritur në të njëjtin konkluzion me të parin – nuk ka qenë për shkak të ndonjë mangësie apo mosveprimi në hetimin e kryer nga subjekti, por thjesht një vlerësim ndryshe i gjykatës (mbi nevojën e përsëritjes së ekspertimit).

#### **4. Denoncimi \*\*\* prot., datë 26.2.2021, nga shtetasi L.B**

221. Denoncuesi ka pretenduar zvarritje të hetimeve, mosnjohim lidhur me vendimet për zgjatjen e hetimeve, favorizim të palës kundërshtare të denoncuesit gjatë hetimit të çështjes së kallëzuar prej tij e të hetuar nga prokurori Platin Aliçka.

<sup>65</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2023.

<sup>66</sup> Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga ankuesi Gj.Gj, kundër vendimit nr. \*\*\* datë 18.1.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës.

222. Nga shqyrtimi i dosjes<sup>67</sup> objekt denoncimi ka rezultuar se Prokuroria pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 4.4.2018, referuar nga Komisariati i Policisë Elbasan, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit F. Q ndaj shtetasit L.B (denoncuesit).
223. Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2023, është bërë me dije për Komisionin se dosja objekt denoncimi aktualisht ndodhet në Gjykatën e Lartë.
224. Lidhur me kohëzgjatjen e hetimeve nga ana e tij, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se në datën 4.4 2018 është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal, emri i personit që i atribuohet vepra penale, si dhe delegimi i veprimeve hetimore, përpiluar nga prokurori, si dhe ka listuar veprimet hetimore, si marrja në pyetje e personave që kanë dijeni mbi veprën penale, vendimi i datës 3.4.2018 për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor etj. Veprimet hetimore të kryera lidhur me procedimin në fjalë kanë zgjatur deri në datën 1.10.2018. Ai ka sqaruar se zgjatja e afatit të hetimeve është bërë si rrjedhojë e përmbajtjes së kërkesave të mbrojtësve për kryerje veprimesh hetimore (të datave 18.6.2018, 13.7.2018 dhe 17.7.2018), duke përfshirë marrje deklarimi të ekspertit mjekoligjor dhe të oficerit të policisë gjyqësore, që ka kryer hetimin e arrestimin në flagrancë të shtetasit L.B në momentet e para, fakte që provojnë dijeninë e mbrojtësve të të pandehurit për aktin e zgjatjes së afatit, edhe pse nuk është nënshkruar më një akt të shkruar. Me aktin e datës 4.4.2018, eksperti mjekoligjor ka konkluduar se tek shtetasi F. Q. janë konstatuar dëmtime, të cilat kanë shkaktuar paaftësi për punë në masën mbi 9 ditë.
225. Me kërkesën e datës 4.4.2018, prokurori i ka kërkuar gjykatës vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj të dyshuarit për kryerjen e veprës “Goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.4.2018, ka vendosur të vlerësojë të ligjshëm arrestin, si dhe të caktojë masën e sigurimit personal detyrim paraqitje në policinë gjyqësore, sipas nenit 234 të Kodit Penal. Në datën 1.10.2018, subjekti i është drejtuar gjykatës me kërkesë për gjykimin e çështjes në ngarkim të personit nën hetim, shtetasit L. B, i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.7.2019, ka vendosur deklarinim fajtor të shtetasit L. B. dhe dënimin e tij.
226. Në vijim, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.2.2020, ka arsyetuar se vendimi nr. \*\*\*, datë 4.7.2019, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal, në aspektin e çmuarjes së vërtetësisë, fuqisë provuese dhe mjaftueshmërisë së provës në procesin penal. Gjithashtu, ajo ka vlerësuar se vendimi në fjalë ishte dhënë në mungesë të analizës ligjore të fakteve dhe në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore. Për rrjedhojë, vendimi duhej të ndryshohej duke u deklaruar i pandehuri i pafajshëm.
227. Lidhur me mosnjoftimin e palëve, në përgjigje të pyetësorit nr. 4 subjekti ka sqaruar se nuk ka bërë njoftimin e kërkesës për dërgimin për gjykim, pasi në bazë të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale nuk kërkohet. Ndërsa lidhur me komunikimin e vendimit për kryerje ekspertimi mjekoligjor për shtetasin F.Q, subjekti ka parashtruar se nuk ka, pasi në atë moment policia gjyqësore nuk e ka pasur në cilësinë e të pandehurit dhe as të personit nën

---

<sup>67</sup> Administruar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2023.



hetim shtetasin L.B, që të detyrohej komunikimi sipas nenit 179 të Kodit të Procedurës Penale.

228. Pas analizimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, si dhe shpjegimeve të subjektit lidhur me procedimin objekt denoncimi, Komisioni ka konstatuar se referuar Kodit të Procedurës Penale të kohës (pasi kishin hyrë në fuqi ndryshimet e këtij Kodi në vitin 2017), në nenin 324, pika 3<sup>68</sup> parashikon se prokurori është i detyruar që vendimin për zgjatjen e hetimeve t'ia komunikojë të pandehurit dhe viktimës, të cilët, sipas nenit 325, pika 1<sup>69</sup>, kanë të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj këtij vendimi. Në nenin 327 të tij përcaktohej se: “ 2. Brenda afatit të parashikuar nga neni 324 i këtij Kodi, prokurori njofton mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehurit, mbrojtësin e tij, si dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit. 3. Njoftimi përmban përshkrimin e përmbledhur të faktit penal për të cilin procedohet, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje. 4. I pandehuri njoftohet gjithashtu se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklarime apo të kërkojë që të merret në pyetje. Kur i pandehuri kërkon të pyetet, prokurori është i detyruar të procedojë me pyetjen e tij”.
229. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime lidhur me njoftimin për zgjatjen e afatit të hetimit dhe njoftimin e kërkesës për dërgimin për gjykim të të pandehurit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

230. Në prapësimet e tij, subjekti i ka qëndruar të njëjtave shpjegime të dhëna edhe përgjatë hetimit kur është pyetur nga Komisioni. Lidhur me mosnjoftimin e kërkesës për gjykim, subjekti ka sqaruar se me ndryshimet e reja të Kodit Penal, në nenin 331 nuk përcaktohet shprehimisht detyrimi për njoftimin e kërkesës për dërgimin për gjykim. Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 35/2017, detyrimi për njoftimin e të pandehurit dhe mbrojtësit është përcaktuar në nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale, edhe me pasojë pavlefshmërie të kërkesës për gjykimin nëse nuk respektohen përcaktimet e këtij neni (327), siç përcakton neni 331, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.
231. Në lidhje me njoftimin e zgjatjes së afatit të hetimeve për këtë procedim penal, subjekti ka sqaruar se gjatë periudhës së përfundimit të afatit tremujor dhe më pas, ka qenë në komunikim me mbrojtësit e të pandehurit L.B me kërkesa për marrje provash dhe efektivisht ai ka qenë në dijeni të zgjatjes së afatit të hetimeve sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, e provuar më kërkesat e tij adresuar institucionit të prokurorisë, ku ka kërkuar edhe përjashtimin e subjektit. Konkretisht, referuar kërkesave të datave 18.6.2018, 13.7.2018 dhe 17.7.2018, të ndodhura në fashikull, zgjatja e afatit të hetimeve jo vetëm si akt procedural, por edhe si shtrirje në kohë, kryesisht është bërë si rrjedhojë e përmbajtjes së kërkesave të mbrojtësve për kryerje veprimesh hetimore duke përfshirë marrje deklarimi të ekspertit mjekoligjor dhe të oficerit të policisë gjyqësore që ka kryer hetimin e arrestimin në flagrancë të shtetasit L.B në momentet e para, fakte që provojnë dijeninë e mbrojtësve të të pandehurit për aktin e zgjatjes së afatit.

<sup>68</sup> Neni 324 parashikon se: “...3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe viktimës”.

<sup>69</sup> Neni 325 parashikon se: “1. I pandehuri dhe viktimja kanë të drejtë brenda dhjetë ditëve nga njoftimi të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve....”.

## Vlerësimi i trupit gjykues

232. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se i pandehuri L.B dhe mbrojtësit e tij jo vetëm që kanë ardhur në dijeni gjatë procesit të hetimit, por edhe në përfundim të hetimeve janë njohur me aktet në tërësi, përfshi dhe zgjatjen e afatit ku ka nënshkrim.
233. Po kështu, në vendimin për dërgimin për gjykim të çështjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, është shqyrtuar ky pretendim për komunikim aktesh nga mbrojtësit e të pandehurit dhe është konkluduar se mbrojtësit e të pandehurit kanë dijeni për zgjatjen e afatit në datën 4.7.2018, pasi kanë kërkuar marrje provash të reja. Më pas është njohur edhe në përfundim të hetimeve dhe nuk ka ngritur asnjë pretendim për kundërshtim të afatit të hetimit.
234. Gjithashtu, ka rezultuar edhe një vendim mbi kërkesën e palëve të Drejtuesit të Prokurorisë (E.M), i datës 19.7.2018, ku evidentohet konstatimi i vendimmarrjes së prokurorit sipas kërkesave të palës (L.B faqe 236-237-238 fashikulli).
235. Ndonëse *de facto* është provuar marrja dijeni për dërgimin e kërkesës për gjykim nga i pandehuri, ky fakt nuk e zbeh detyrimin ligjor për njoftimin e tij nga subjekti konform përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, ky rast i vetëm, dhe në kushtet kur nuk ka rezultuar me pasoja në drejtim të cenimit të të drejtave procedurale të palës, nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për penalizimin e subjektit sa i takon aftësive të tij profesionale.

### 5. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021, nga shtetasja S.J

236. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi nuk ka rezultuar të përmendet subjekti apo të ngriheshin pretendime lidhur me veprimtarinë e tij si prokuror. Në këto kushte, ky denoncim nuk mund të shqyrtohet më tej nga Komisioni, për sa kohë ai nuk i ka përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

### 6. Denoncimi i shtetases S.S (i përcjellë nga ONM-ja)

237. Denoncuesja në fjalë ka parashtruar se ajo ka paraqitur një ankim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
238. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2018 (objekt denoncimi), subjekti ka shpjeguar se kjo çështje penale fillimisht ka qenë e hetuar nga prokurori G.H. Pas kalimit të tij në një detyrë tjetër i është shortuar subjektit vetëm në datën 28.3.2023.
239. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se në procedimin penal nr. \*\*\*/\*\*\*, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan që kishte prishur vendimin e mosfillimit të prokurorit H kishte lënë si detyrë të verifikohej pretendimi i kallëzueses S. S nëse shtetasi R. O ushtronte detyrën e ekspertit mjekoligjor (kishte kryer ekspertizë mjekoligjore për procedimin penal nr. \*\*\*/\*\*\*).
240. Subjekti, bazuar në përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 2.5.2023, ka konkluduar se Dr. R.O ka ushtruar detyrën si ekspert mjekoligjor (i jashtëm) për rrethin e Elbasanit. Në vijim, në datën 12.5.2023 janë përfunduar hetimet dhe është përpiluar kërkesa për pushimin e çështjes, e cila është dërguar në gjykatë, ku dhe vijon të jetë në proces.
241. Në përfundim të analizimit të dokumentacionit të administruar, si dhe pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se në rastin në analizë është konstatuar se në

raport me veprimtarinë e subjektit në këtë dosje – ndonëse ajo ka qenë e pjesshme dhe vetëm në një segment kohor (pasi hetimi është nisur nga një tjetër prokuror) nuk kanë rezultuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Gjithsesi, vërehet se çështja në fjalë ende gjendet në pritje të shqyrtimit nga gjykata.

## LIDHUR ME DISA FAKTE TË BËRA PUBLIKE NGA MEDIA

### 1. Lidhur me një publikim në emisionin investigativ \*\*\*

242. Komisioni është vënë në dijeni nga mjetet e informimit publik lidhur me një artikull të publikuar në median *online*, konkretisht në emisionin “\*\*\*”<sup>70</sup>, në të cilin raportohet se: *“Dosja e vjedhjes së cigareve në P të Elbasanit, për 5 vjet u hetua nga 8 prokurorë në Elbasan, nga P. S e deri te E.B e Platin Aliçka. B nisi ta hetonte çështjen, por u përjashtua nga Vettingu. Platin Aliçka e zvarriti 1 vit dhe po tenton ta nxjerrë pa lagur të dyshuarin kryesor I.B”*.
243. Në këtë emision, ish-prokurori i çështjes E. B tregon se si eksperti G.H dhe P.S kanë marrë para nga I.B, duke i lënë atij të ruante cigaret e vjedhura.
244. Prokuroria<sup>71</sup> ka bërë me dije se me vendimin e datës 17.3.2022 është bërë zëvendësimi i prokurorit E. B. me prokurorin Platin Aliçka. Ky i fundit, në datën 27.1.2023, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me kërkesë për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit I. B, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 287/b dhe 301 të Kodit Penal.
245. Nga gjykata nuk janë përcjellë akte lidhur me këtë çështje, për shkak se ajo vijon të jetë në proces. Në këto kushte, Komisioni e ka ftuar subjektin nëpërmjet pyetësorit nr. 3 të shpjegojë mbi kohëzgjatjen e hetimit dhe veprimet hetimore të kryera, si dhe mënyrën e përfundimit të tyre lidhur me procedimin penal në fjalë.
246. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti ka parashtruar se ka qenë prokurori i 8-të i ngarkuar me hetimin e procedimit penal në fjalë, me shortin e datës 17.3.2022. Ai ka sqaruar se aktualisht kjo çështje nuk përfaqësohet më nga ana e tij, por nga prokurori XH. S., për shkak se ai është transferuar me detyrë në Prokurorinë e Rrethit Tiranë. Subjekti ka listuar veprimet procedurale të kryera prej tij, të cilat kanë filluar në datën 23.3.2022 dhe kanë vijuar deri në datën 28.10.2022, kur është urdhëruar regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale I.B dhe L.K . Më 31.10.2022 është vendosur marrja si i pandehur i shtetasve I. B dhe L.K . Më 16.11.2022 u është komunikuar akti i marrjes si të pandehur shtetasve të mësipërm. Më 6.1.2023 kanë përfunduar hetimet dhe pas afatit 10-ditor është kërkuar dërgimi për gjykim. Çështja është në fazën e seancës paraprake, pa një vendim gjyqësor.
247. Në analizë të sa më sipër, ka rezultuar se subjekti përgjatë kohës që ka qenë i caktuar për ndjekjen e procedimit në fjalë ka ndër marrë një sërë veprimesh hetimore të vlerësuara prej tij si të dobishme në funksion të zbardhjes së çështjes, të cilat kanë zgjatur rreth 9 muaj, për shkak të administrimit të provave, sikurse ka qenë edhe vendimi për kryerjen e ekspertimit në muajin maj të vitit 2022, ndërkohë që akti i ekspertimit është administruar në tetor të po këtij viti.

<sup>70</sup> [https://\\*\\*\\*.al/per-leket-jemi-bere-armik-i-popullit-kamera-e-fshehte-prokurorit/](https://***.al/per-leket-jemi-bere-armik-i-popullit-kamera-e-fshehte-prokurorit/)

<sup>71</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2023.

248. Në përfundim, Komisioni vlerëson se në rastin në analizë është konstatuar se në raport me veprimtarinë e subjektit në këtë dosje – ndonëse ajo ka qenë e pjesshme dhe vetëm në një segment kohor/qendror – nuk kanë rezultuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit.
249. Gjithashtu duhet të mbahet në vëmendje se edhe pse veprimet e subjektit janë përshkruar dhe analizuar më sipër, për sa kohë kjo dosje është ende në gjykim, në lidhje me të nuk mund të kryhet nga Komisioni një vlerësim i mirëfilltë dhe përfundimtar.

## **2. Lidhur me një publikim në emisionin investigativ \*\*\*<sup>72</sup>, si dhe në gazetën “\*\*\*\*”<sup>73</sup>**

250. Emisioni “\*\*\*\*” ka publikuar aksidentin ku mbeti viktimë shtetasi Gj.P, si pasojë e përplasjes nga një kamionçinë, ndërkohë që ai vetë drejtonte një motor. Ky emision ka raportuar ndër të tjera se nga hetimet, për të njëjtin kampion gjaku, kishin rezultuar 3 vlera të ndryshme të pranisë së alkoolit në gjakun e viktimës.
251. Nga shqyrtimi i dosjes së procedimit penal në fjalë<sup>74</sup>, nr. \*\*\*, datë 16.10.2015, ka rezultuar se prokurori i çështjes në datën 17.2.2016 ka kërkuar pushimin e procedimit penal<sup>75</sup>. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.10.2016<sup>76</sup>, gjykata ka vendosur prishjen e vendimit të pushimit dhe kthimin e çështjes për hetim.
252. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.11.2017, çështja i është caktuar prokurorit Platin Aliçka, i cili ka ndërmarrë veprimet hetimore sipas detyrave të lëna nga gjykata.
253. Në përfundim të hetimeve, në datën 26.7.2018, duke marrë në analizë edhe aktin e III-të autoteknik ku ekspertët kanë përcaktuar shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesit e mjeteve të përfshira në aksident, subjekti i është drejtuar gjykatës me kërkesën për pushim. Gjukata me vendimin nr. \*\*\* ka vendosur kthimin e akteve dhe plotësimin e hetimit, me qëllim përcaktimin e shkakut determinant nga ana e ekspertëve me një akt shtesë ekspertimi apo me një akt të ri ekspertimi (në vlerësim të prokurorit). Pas ankimimit të këtij vendimi nga prokurori, Gjukata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjukatës së Rrethit Gjqësor Elbasan.
254. Në vijim, prokurori Platin Aliçka ka urdhëruar rikryerjen e ekspertimit autoteknik, duke i lënë si detyrë (veç pyetjeve) edhe përcaktimin e shkakut determinant (siç kishte kërkuar gjykata).
255. Katër ekspertët kishin konkluduar, veç shkeljeve nga ana e viktimës, edhe mossinjalizimin në kohën e duhur nga ana e drejtuesit të automjetit, sipas nenit 152/3 të Kodit Rrugor. Sipas dëshmitarëve, automjeti kishte ndezur sinjalin për kthimin e tij djathtas dhe mjete motorik ka parakaluar po në të djathtë.
256. Në vijim, me kërkesën e datës 2.12.2019, subjekti i është drejtuar sërish gjykatës me kërkesën për pushimin e çështjes. Gjukata, në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërkesë, me vendimin e saj nr. \*\*\*, datë 4.12.2020, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe plotësimin e

<sup>72</sup> [https://\\*\\*\\*.tv/video/\\*\\*\\*-fajsohet-viktima-pas-aksidentit-nena-dua-drejtjesi/](https://***.tv/video/***-fajsohet-viktima-pas-aksidentit-nena-dua-drejtjesi/)

<sup>73</sup> [https://\\*\\*\\*\\*.com/aktualitet/fiks-fare--fajto-re-pas-aksidentit-impl-nxjerr-te-njejtin-kampio-i1174179/](https://****.com/aktualitet/fiks-fare--fajto-re-pas-aksidentit-impl-nxjerr-te-njejtin-kampio-i1174179/)

<sup>74</sup> Administruar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2023.

<sup>75</sup> Një ndër veprimet hetimore të kryera ka qenë ekspertimi toksikologjik i datës 23.10.2015, nga i cili ishte konstatuar prania e alkoolit në gjak tek viktimja (fillimisht është konstatuar mungesa e pranisë së alkoolit, por ky ekspertim është përsëritur për shkak të një gabimi në numërim të konstatuar nga vetë ekspertja. Ekspertimi është përsëritur me të tjerë ekspertë dhe është konstatuar prania e alkoolit në gjak).

<sup>76</sup> Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjukata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.10.2017.

hetimeve duke lënë si detyrë të re kryerjen e një akti të ri ekspertimi autoteknik me grup tjetër ekspertësh.

257. Pas kryerjes së riekspertimit të fundit, datë 15.7.2021, ekspertët kanë dalë unanimisht në këtë konkluzion përfundimtar: *“Referuar fakteve, provave të vëna në dispozicion, mekanizmit të ndodhjes së ngjarjes, llogaritjeve analitike të kryera, sjelljet e të dy përdoruesve të rrugës, të përfshirë në aksident, kanë arritur në konkluzionin se parakalimi i gabuar (në të djathtë), mosruajtja e distancës së sigurisë dhe mosrregullimi i shpejtësisë në funksion të kushteve të rrugës nga ana e drejtuesit të mjetit motor, shtetasit Gj. P , kanë ndikuar teknikisht në ndodhjen e aksidentit”*<sup>77</sup>.
258. Në vijim, në datën 21.7.2021, subjekti i është drejtuar përsëri gjykatës me kërkesë për pushim. Kjo kërkesë është pranuar nga gjykata me vendimin nr. 14.8.2021, datë 3.11.2021. Më pas, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.1.2022, Gjykata e Apelit Durrës ka arsyetuar ndër të tjera se referuar aktit të ekspertimit të datës 15.7.2021 është arritur në konkluzionin se parakalimi i gabuar, mosruajtja e distancës dhe rregullimi i shpejtësisë në funksion të kushteve të rrugës nga ana e viktimës, kishin ndikuar teknikisht në ndodhjen e aksidentit. I njëjti konkluzion ishte arritur edhe nga aktet e mëparshme të ekspertimeve autoteknike (të datave 16.10.2015 dhe 16.2.2016). Gjykata është shprehur gjithashtu në vendim se konkluzioni i mësipërm ishte mbështetur edhe nga prova të tjera si: deklaratimet e dëshmitarëve, këqyrja e vendit të ngjarjes, aktet e ekspertimeve toksikologjike, sipas të cilave ishte konstatuar prania e alkoolit në gjak te viktima. Në përfundim të shqyrtimit të akteve dhe provave, gjykata ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë nr. \*\*\*, datë 3.11.2021 (me të cilin ishte vendosur pranimi i kërkesës së subjektit), duhet të lihej në fuqi.
259. Përgjatë hetimit, Komisioni e ka ftuar subjektin të japë sqarime lidhur me sa është parashtruar më sipër. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka shpjeguar se ka përmbushur çdo detyrë të lënë nga gjykata. Konkretisht, janë kryer dy akte ekspertimi autoteknike me anë të të cilave është konkluduar se shkak determinant për ardhjen e pasojës janë shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor të kryera nga viktima Gj. P<sup>78</sup>. Edhe pas rikryerjes së ekspertimit autoteknik është konkluduar sërish për pushimin e çështjes. Më pas, gjykata ka miratuar kërkesën për pushim të kësaj çështjeje penale, e cila aktualisht është e formës së prerë, por e rekursuar.
260. Në përfundim të sa është përshkruar e analizuar më sipër, ka rezultuar se kërkesa e subjektit për pushimin e çështjes nuk është pranuar nga gjykata, për shkak të mospërcaktimit të shkakut determinant të aksidentit nga ekspertët përkatës. Ky fakt ka sjellë si pasojë kthimin e akteve me qëllim plotësimit të hetimit.
261. Nga aktet ka rezultuar se e vetmja provë e pakristalizuar ka qenë akti i ekspertimit autoteknik (për shkak të moskonkludimit të të gjithë ekspertëve në një mendim unanim).
262. Komisioni ka konstatuar se pavarësisht se ekspertët kanë qenë të ndarë në 2 grupe sipas opinionëve të tyre lidhur me çështjen, në të gjitha aktet e ekspertimit është konkluduar se nga ana e viktimës ishin kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe vetëm në një prej tyre është konkluduar se edhe drejtuesi i mjetit kishte kryer shkelje. Po ashtu, nga aktet ka

<sup>77</sup> Cituar në faqen nr. 8 të vendimit nr. \*\*\* nr. sistemi (\*\*\*) datë 3.11.2021 dhe faqe 12 e vendimit nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 20.1.2022, të Gjykatës së Apelit Durrës, formë e prerë.

<sup>78</sup> Akti i parë faqet 88-97 e fashikullit të procedimit penal nr. \*\*\*, volumni \*\*\*. Akti i dytë faqet 108-119 të fashikullit të procedimit penal nr. \*\*\*, volumni \*\*\*.

rezultuar se edhe provat e tjera të administruara gjatë hetimit dëshmonin në të njëjtën linjë arsyetimi (akti i ekspertimit toksikologjik, dëshmitarët etj.).

263. Lidhur me shkakun determinant që ka passjellë aksidentin, referuar qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 45, datë 23.7.2012, pika 7, ku citohet se *“Gjykata vëren së akti i ekspertimit është një prove shkencore që, edhe pse mbart në vetvete shumë avantazhe, për gjykatën do të mbetet një provë si gjithë llojet e tjera të provave që do të marrë vlerën dhe fuqinë e saj provuese vetëm mbasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e çmojnë atë. Çmuarja e provës, pra edhe i asaj me ekspert, bëhet duke nxjerrë vlerën e saj provuese në koherencë me provat e tjera të procesit gjyqësor. Në këtë aspekt, gjykata vlerëson se mendimet e ekspertit përbëjnë vetëm një këshillë për gjykatën, të cilat nuk janë aspak të detyruara që të pranojnë apriori këto mendime, përveçse kur i bindin. Fakti se eksperti ofron mendime të specializuara për gjykatën në një fushë jojuridike, bën që mendimi i ekspertit të tërheqë vëmendje më të madhe në momentin e çmuarjes së tij nga ana e gjykatave të zakonshme dhe se këto të fundit duhet të argumentojnë me hollësi mendimin e kundërt. Nëse ato nuk pranojnë mendimin e ekspertit duhet të paraqesin argumente bindëse, por kjo nuk do të thotë se gjykatat duhet të pajtohen gjithmonë me konkluzionet e ekspertëve”,* është interpretim që përfshin anën teknike dhe jo interpretim juridik.
264. Nisur nga sa më sipër, duke iu referuar vetëm segmentit kohor ku hetimi i kësaj çështjeje është drejtuar nga z. Aliçka – ky subjekt ka kryer hetime të plota dhe të gjithanshme dhe se asnjë nga aktet hetimore nuk është deklaruar nga gjykata i pavlefshëm apo i papërdorshëm – madje ato kanë pasur fuqi provuese për procesin penal në fjalë, si dhe janë vlerësuar si të tilla edhe në vendimin e gjykatave, që tashmë ka marrë formë të prerë. Gjithashtu, arsyetimi i kërkesës për pushimin e çështjes penale ka qenë i plotë dhe është bërë në referim të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, pas konstatimit të mungesës së anës objektive dhe subjektivit të veprës penale dhe se ajo është pranuar nga gjykatat e të dyja shkallëve, pa evidentuar problematika procedurale apo substanciale.
265. Në përfundim, Komisioni vlerëson se në rastin në analizë është konstatuar se në raport me veprimtarinë e subjektivit në këtë dosje – ndonëse ajo ka qenë e pjesshme dhe vetëm në një segment kohor/qendror (pasi hetimi është nisur nga një tjetër prokuror dhe pas aktivizimit/përfshirjes së pjesshme të subjektivit, hetimi është vijuar gjithashtu nga një tjetër prokuror) – nuk kanë rezultuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, duhet të mbahet në vëmendje se ndonëse veprimet e subjektivit janë përshkruar dhe analizuar më sipër, për sa kohë kjo dosje është ende nën hetim, çmohet se në lidhje me të as nuk mund të kryhet nga Komisioni një vlerësim i plotë dhe përfundimtar në raport me aftësitë profesionale të subjektivit.
266. Në konkluzion përfundimtar lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se për subjektivin e rivlerësimit nuk është konstatuar mangësi profesionale, mosrespektim i të drejtave të palëve apo të dispozitave që përcaktojnë hapat proceduralë e, kësisoj, z. Platin Aliçka vlerësohet me një nivel profesional bindshëm kualifikues.
267. Trupi gjykues çmon se duke e parë në tërësinë e vet rivlerësimin e aftësive profesionale, këto problematika nuk përbëjnë shkak penalizues, për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje të rënda procedurale dhe/ose mosrespektim të të drejtave të palëve, me pasoja për këta të fundit apo arsyetime të dobëta ose të paplota në vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Platin Aliçka:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Platin Aliçka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 3.4.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleđa ÇIFTJA**  
Kryesuese

**Lulzim HAMITAJ**  
Relator

**Roland ILIA**  
Anëtar